

Sylë Ukshini, PhD¹

**GJERMANIA DHE ÇËSHTJA SHQIPTARE NË KONFERENCËN E
AMBASADORËVE NË VITET 1912-1913**

**ГЕРМАНИЈА И АЛБАНСКОТО ПРАШАЊЕ НА
КОНФЕРЕНЦИЈАТА НА АМБАСАДОРИ ВО 1912-1913 ГОДИНА**

**GERMANY AND THE ALBANIAN QUESTION AT THE
AMBASSADORS' CONFERENCE IN 1912-1913**

Abstrakt

Në periudhën e krizës ballkanike të fillimit të shekullit XX, një konferencë ndërkombëtare për të zgjidhur konfliktet e Ballkanit ishte një nevojë emergjente për të shmangur shpërthimin e një lufte të përgjithshme në Evropë. Kjo nevojë u materializua në Konferencën e Londrës të vitit 1912, e cila synonte të menaxhonte ndikimet dhe pretendimet e shteteve ballkanike pas luftës së parë ballkanike dhe përgatitjen për një zgjidhje të qëndrueshme për Shqipërinë.

Ky studim shqyrton pozicionin e diplomacisë gjermane gjatë kësaj Konference, duke analizuar rolin e përfaqësuesve gjermanë dhe ndikimin e politikës së Berlinit në vendimmarrjet e Konferencës. Në veçanti, trajtohet angazhimi i princit Lichnowsky, ambasadorit gjerman, dhe tensionet mes tij dhe autoriteteve të Berlinit, si dhe qëndrimet e tjera të Fuqive të Mëdha ndaj çështjes shqiptare.

Ndërsa Austria-Hungaria, me ndihmën e diplomatëve të saj, kërkonte një Shqipëri të përfshirë tërësisht brenda kufijve etnografikë të shqiptarëve, Gjermania, e udhëhequr nga kritika e Perandorit Wilhelm II, e pa të pamundur mbajtjen e trupave osmane në Shqipëri dhe vlerësoi se parimi i përcaktimit të kufijve në bazë etnografike ishte i realizueshëm vetëm në kushte të caktuara. Përfaqësuesit gjermanë gjithashtu kontribuan në përcaktimin e kufijve të Shqipërisë dhe në diskutimet për neutralitetin e saj, ndihmuar nga një koordinim të ngushtë me Austro-Hungarinë dhe bashkëpunim të kujdesshëm me diplomatët e tjerë të Konferencës.

¹ Prof. Dr. Sylë Ukshini, Universiteti “Kadri Zeka” Gjilan/ Republika e Kosovës.

Ky punim ka në fokus ndriçimin e kompleksitetit të rrethanave të krijuar rreth pushtimit serbo-malazez të qytetit të Shkodrës, e cili ishte e vetmja qendër politike administrative shqiptare që do të mbetej brenda kufijve të shtetit shqiptar, natyrisht qëndrimit konsekuent të diplomacisë austro-hungareze. Në këtë rrethanë evidentohet edhe qëndrimi i luhatur i shtetit gjerman rreth kësaj çështje dhe veçanërisht pozicioni i princit Lichnowsky, i cili shpesh mbajti qëndrime që shkonin përtej qëndrimit të shtetit gjerman. Punimi ofron një analizë të detajuar të ndikimeve dhe përpjekjeve të diplomacisë gjermane për të mbrojtur interesat e saj dhe për të ndikuar në rezultatet e Konferencës që do të formësonin hartën politike të Ballkanit për dekadat e ardhshme.

Hyrje

Në përpjekje për zgjidhjen e problemeve midis shteteve fituese të Aleancës Ballkanike dhe Perandorisë Osmane, e cila për pak javë u shemb në pjesën e saj evropiane, Fuqitë e Mëdha ndërmorën nismën për thirrjen e një Konferencë Evropiane të paqes. Në këto rrethana, Austro-Hungaria ishte fuqia kryesore evropiane që ishte vënë në mbrojtjes të çështjes shqiptare. Ndërkohë, Gjermania, aleati i Austro-Hungarisë në kuadër të Aleancës Trepalëshe, ishte e lidhur ngushtë për interesat e saj ekonomike dhe për këtë arsye ajo nuk kishte ndonjë interes të drejtpërdrejtë për Shqipërinë. Megjithatë, ajo ishte deklaruar se do të ndiqte qëndrimin e Vjenës në çështjet ballkanike. Për ndërtimin e një pozicioni sa më unik të këtyre dy vendeve, Vjena kishte dërguar në Londër kont Albert Mensdorff-in² si drejtues i Aleancës Tripalëshe, ndërsa ambasadori gjerman princ Lichnowsky ishte mbështetësi i tij kryesor. Ndërsa në Berlin, çështjet drejtoheshin nga Count László Szógyény-Marich,³ i cili

² Count von Mensdorff-Pouilly-Dietrichstein hyri në shërbimin diplomatik të Austro-Hungarisë në vitin 1884 dhe fillimisht u caktua si atashe në ambasadën në Paris, për t'u transferuar më pas në Londër në vitin 1889. Lidhjet e tij familjare me oborrin britanik vinin përmes martesës së gjyshit të tij, Count Emmanuel von Mensdorff-Pouilly, me hallën e Mbretëreshës Viktoria, Princeshën Sophie të Saxe-Coburg-Saalfeldit; gjithashtu, babai i tij kishte qenë djalë i pagëzuar dhe kushëri i preferuar i bashkëshortit të Mbretëreshës Viktoria, Princit Albert. Më 6 maj 1904, ai paraqiti letrat kredenciale si ambasador i Monarkisë së Dyfishtë në Oborrin e Shën Xhejmsit. Shih: Mensdorff-Pouilly-Dietrichstein Albert Graf, Österreichisches Biographisches Lexikon 1815-1950

³ Count László Szógyény-Marich, një diplomat austro-hungarez me origjinë hungareze, i cili shërbeu për një kohë të gjatë si ambasador në Berlin. Më 24 tetor 1892, Perandori Franz Joseph I e emëroi Count László Szógyény-Marich ambasador në Gjermani, dhe ai paraqiti letrat kredenciale te Kajzeri në Berlin më 12 nëntor. Ai e mbajti këtë post për njëzet e dy vjet, një mandat jashtëzakonisht i gjatë edhe për standardet e kohës. Pozitën e tij e kishte siguruar falë lidhjeve të ngushta, veçanërisht mbrojtjes së Franz Joseph-it. Ai kishte qenë një mik dhe besnik i Princit të Kurorës Rudolf dhe ishte marrë me dokumentet e tij pas incidentit të Mayerlingut, dhe as Count Lexa von Aehrenthal nuk mundi ta zëvendësonte. Shih: D. Godsey Willima, Aristocratic Redoubt: The Austro-Hungarian Foreign Office on the Eve of the First World War, West Lafayette, Purdue University Press, 1999, f. 167.

këmbëngulte se një qëndrim ndryshe do të shkaktonte një “casus foederis” (arsye për luftë). Kur unë shpreha dyshime për këtë përfundim.

Shembja e shpejtë e sundimin osman në Ballkan dhe zgjerimi territorial i shteteve ballkanike shkaktoi shqetësim në Vjenë, ku kishte pikëpamje, sidomos në qarqet ushtarake, se duhej të ndërhyhej ushtarakisht për të penguar planet se shteteve ballkanike, sidomos të Serbisë për të shtënë në dorë bregun lindor të Adriatikut. Nga ana tjetër, Ballplatzi (Ministria e Jashtme), që i përmbahej arritjes së objektivave nëpërmjet diplomacisë dhe jo luftës, synonte të ndërtonte të ndërtonte politikën ballkanike mbi këto tri elemente: mospërfshirje në luftë për ndarje territoriale midis shteteve ballkanike, dhe krijimin e një Shqipërie të pavarur të lidhur ngushtë me Vjenën, që duhej të kompensonte mungesën e përfitimeve territoriale austro-hungareze. Në anën tjetër, ishte Rusia ajo që synonte ta mbështeste Serbinë në kauzat territoriale, të cilat binin ndesh me synimet austro-hungareze, por rusët tani nuk dëshironin një tjetër poshtërim pas atij të pësuar prej japonezëve (1904-1905) dhe prej austro-hungarezëve në Bosnjë dhe Hercegovinë (1908-1909), ndërkohë qeveria gjermane ishte e përgatitur të ndiqte vijën e ndërmarrë nga partnerët e saj në Aleancë.⁴ Në anën tjetër, Theobald von Bethman Hollweg, kancelar gjerman, shpalli ripërtëritjen e Traktatit të Aleancës së Trefishtë, ai kishte deklaruar se Gjermania ia linte aleates së saj, Austro-Hungarisë, t’i realizonte vetë aspiratat e saj ballkanike.⁵ Në të njëjtën kohë, qeveria gjermane ishte e gatshme të ndiqte vijën e ndjekur nga partnerët e saj në Aleancë, ndonëse me ndërlikimin e mëtejshëm që ajo mund të kishte në mes Austro-Hungarisë dhe Italisë. Pra, Berlioni synonte të minimizonte divergjencat mes partnerëve të Aleancës me qëllim që ajo të mbetej unike.⁶

Për ta evituar një rrezik të tillë, fuqitë evropiane filluan të angazhoheshin për organizimin e një konference evropiane të paqes, përmes së cilës do të adresoheshin çështjet e riorganizimit të Ballkanit, në këtë kuadër edhe çështja shqiptare. Megjithatë, rruga drejt Traktatit të Londrës ishte treguar jashtëzakonisht e vështirë edhe për gjashtë fuqitë e mëdha.

Por, fillimisht ministri i jashtëm gjerman Kinderlen-Wächter ishte kundër organizimit të një konference të përbashkët nga Fuqitë e Mëdha për trajtimin e problemeve në Ballkan. Sipas tij, Aleanca Ballkanike i kishte artikuluar qartë kërkesat e saj ndaj Perandorisë Osmane, dhe tashmë duheshin pritur rezultatet e saj.⁷ Duke u mbështetur në një propozim të hershëm, ai i propozoi Fuqive të Mëdha që nëpërmjet një programi të përbashkët veprimi të ndërhynin mes palëve kundërshtarë. Një pikë e përbashkët, sipas ideve të Sekretarit gjerman të shtetit, duhej të ishte pavarësia e Shqipërisë. Ai besonte

⁴ Guy, Nicola, Lindja e Shqipërisë. Pegi, Tiranë, 2012, f. 59-63.

⁵ Guy, Nicola, Lindja e Shqipërisë. Pegi, 57.

⁶ Guy, Nicola, Lindja e Shqipërisë. Pegi, 57. Guy, Nicola, Lindja e Shqipërisë. Pegi, 57.

⁷ Löhr, Hanns Christian, Hanns Christian, Die Gründung Albaniens, f. 39.

se kjo do të dëshirohej nga të gjitha palët. Njëkohësisht, ai këshilloi gjithashtu që Serbisë t'i bëheshin lëshime vetëm në formën e një linje hekurudhore me një port të Adriatikut dhe në këtë mënyrë të mos ndodhte asnjë përfitim nga territori shqiptar.⁸ Më 18 dhjetor 1912 ai i propozoi ministrit të Jashtëm anglez, Viscount Edward Grey of Falladon, bisedime të drejtpërdrejta të Fuqive të Mëdha mbi Ballkanin.⁹ Nga ana e tij, ministri i Jashtëm britanik Grey e konkretizoi më tej idenë gjermane duke propozuar tri pika të rëndësishme: E para, Fuqitë e Mëdha duhej të diskutonin mbi pavarësinë e Shqipërisë. E dyta, të diskutohej mbi mundësinë e një lidhje të Serbisë me detin Adriatik dhe së treti, të vendosej për të ardhmen e ishujve turq të Egjeut, të cilët për momentin mbaheshin të pushtuara nga Greqia.

Përfundimisht me nismën e ministrit të Jashtëm britanik Grey, Fuqitë e Mëdha ranë dakord për mbajtjen e një Konference evropiane. Më 16 dhjetor 1912, ambasadorët e vendeve që kishin nënshkruar Traktatin e Berlinit të vitit 1878 - Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Rusia, Austro-Hungaria dhe Italia - u mbledhën në një konferencë në Londër. Si përfaqësues i Ministrisë së Jashtme të vendit pritës, Edward Grey u zgjodh kryetar i përhershëm i Konferencës.¹⁰

Konsensusi mes pjesëmarrësve ishte që konflikti në Ballkan të mos përshkallëzohej në një luftë serioze me përfshirjen e fuqive të mëdha evropiane. Gjatë luftimeve, kishte pasur gjithashtu tensione të forta të ambasadorëve, u zhvillua në mënyrë të pazakonshme,¹¹ sepse takimet ishin më tepër formale, duke mos ndjekur protokoll. Përcaktimi i kufijve midis vendeve të Aleancës Ballkanike nuk u vendos nga fuqitë e mëdha evropiane. Këto çështje thelbësore iu lanë vetë shteteve ballkanike që ishin në luftë. Fuqitë e mëdha të Kongresit të Berlinit u dhanë vendeve ballkanike mundësinë për të vendosur vetë për çështjet e tyre. Me këtë pavarësi në politikën e jashtme, u krijua një bazë e re juridike ndërkombëtare.¹² Meqenëse konferenca kishte rëndësi për rregullimin e Ballkanit dhe vinte në sprovë edhe Aleancën Trepalëshe, Gjermania vendosi që në Londër të dërgonte një ambasador të një nivel të lartë, siç ishte princ Lichnowsky. Lichnowsky ishte i ri në këtë rreth, pasi ishte

⁸ Löhr, Hanns Christian, Hanns Christian, Die Gründung Albaniens, f. 40.

⁹ Die Grossen Politik Europäischer Kabinetten, 12500 Kiderlen drejtuar Lichnowsky 18.11. 1912.

¹⁰ Konferenca e Ambasadorëve i filloi punimet më 17 dhjetor 1912. Merrnin pjesë këta ambasadorë të Fuqive të Mëdha: Mensdor i Austro-Hungarisë, Lichnowsky i Gjermanisë, Imperial i Italisë, Cambon i Francës dhe Benckendorf i Rusisë.

¹¹ Për sa i përket gjuhës së konferencës, ajo nuk e caktoi frëngjishten si gjuhë zyrtare, por në fakt frëngjishtja ishte ajo që u përdor më tepër, sepse veç Grey-it që preferonte të fliste në gjuhën e tij, të gjithë ambasadorët diskutimet si dhe dokumentet me shkrim (projekte, propozime etj.) i bënin në gjuhën frënge. Helmreich, Ernst Christian, The diplomacy of the Balkan war 1912-1913. Cambridge, Mass. USA 1938, f. 249-250.

¹² Boeckh, Katrin, Von den Balkankriegen zum Ersten Weltkrieg. Kleinstaatenspolitik und ethnische Selbstbestimmung auf dem Balkan, München, 1996, f.51

emëruar së fundmi në postin e tij në Londër. Megjithatë, ai nuk ishte i panjohur me kolegët e tij. Në fakt, tre ambasadorët Benckendorff (Rusi), Mensdorff (Austro-Hungari) dhe Lichnowsky (Gjermani) ishin kushërinj. Nuk u mbajtën procesverbale, megjithatë u bë praktikë e zakonshme që Cambon të përmbledhonte diskutimet e ndryshme. Kjo ishte thelbësore, pasi në këtë mënyrë pikat kryesore të çdo diskutimi u dërgoheshin kryeqyteteve të ndryshme në versione identike.¹³ Megjithatë, shumica e punës nuk bëhej gjatë takimeve zyrtare. Ajo arrihej kryesisht përmes diskutimeve paraprake mes ambasadorëve individualë. Sir Edward Grey, si kryetar i konferencës, merrte drejtimin në lehtësimin e këtyre bisedimeve dhe, kur situata bëhej kritike, ai vendoste agjendën e takimit të ardhshëm përmes konsultimeve private me ambasadorët e ndryshëm.¹⁴ Mensdorff, Lichnowsky dhe Imperiali - sidomos dy të parët - diskutonin së bashku mbi masat që duheshin ndërmarrë. Megjithatë, ata nuk kishin gjithmonë një qëndrim të unifikuar. Mensdorff u ankua në Vjenë për këtë çështje, ndërsa Lichnowsky u qortua nga Ministria e Jashtme e Gjermanisë. Edhe ambasadori rus vuri re mungesën e harmonisë së plotë në kampin kundërshtar.¹⁵

Qysh para fillimit të Konferencës së Ambasadorëve, Berlioni e kishte instruktuar ambasadorin Lichnowsky, për qëndrimin që duhej të mbante në Konferencë. Gjermania duhej të mbante qëndrim konform interesit dhe qëndrimin të shteteve anëtare të Aleancës së Trefishtë. Si dhe duhet të këmbëngulte në formimin e një Shqipërie të pavarur si shtet i qëndrueshëm dhe në kufij të përcaktuar sipas strukturës etnike të popullatës. *Auswärtiges Amt*-i mendonte se Gjermania, për hir të Austro-Hungarisë, nuk mund të hynte në një luftë me Rusinë, e cila mbronte interesat e Aleancës Ballkanike, sidomos të Serbisë. Për Evropën, formimi i Aleancës Ballkanike solli një zhvendosje të rëndësishme në ekuilibrin e fuqive në favor të Antantës, pasi ishte orkestruar nga Rusia.¹⁶ Gjermania dhe Austria, të udhëhequra nga Vjena, u përpoqën ta kundërshtojnë këtë përmes diplomacisë, por dështuan, duke e çuar Evropën drejt luftës.¹⁷ Kështu, ndërsa shtetet ballkanike vepronin me kujdes, fuqitë e mëdha vazhdonin përpjekjet e tyre të vakëta për të parandaluar shpërthimin e armiqësive. Berhtoldi, i cili besonte se preteksti për luftë do të vinte ose nga pretendimet greke ose nga insistimi bullgar për zbatimin e Nenit XXIII të Traktatit të Berlinit, më 26 shtator kërkoi nga Gjermania një shkëmbim opinionesh mbi politikën që duhej ndjekur.¹⁸

¹³ Helmreich, Ernst Christian, *The diplomacy of the Balkan war 1912-1913*, f. 134

¹⁴ Helmreich, Ernst Christian, *The diplomacy of the Balkan war 1912-1913*, f.135.

¹⁵ Helmreich, Ernst Christian, *The diplomacy of the Balkan war 1912-1913*, f.135.

¹⁶ Ministri i Jashtëm rus Sazonov kishte deklaruar se "traktatet e aleancës midis shteteve ballkanike ishin përfunduar pa ndihmën e Rusisë dhe se Rusia nuk ishte informuar për to." Helmreich, Ernst Christian, *The diplomacy of the Balkan war 1912-1913*, f. 40.

¹⁷ Shih. Helmreich, Ernst Christian, *The diplomacy of the Balkan war 1912-1913*, f. 59.

¹⁸ Helmreich, Ernst Christian, *The diplomacy of the Balkan war 1912-1913*, f. 72.

Në vazhdimësi Berlini u tregua më i matur dhe dëshironte të shmangte një konfrontim ushtarak në mes Austro-Hungarisë dhe Rosisë, pasi në një rast të tillë kjo do të thoshte luftë edhe për Gjermaninë. Këmbëngulja e Vjenës në çështjen e Shkodrës ishte një çështje tjetër që acaroi raportet e Vjenës me Beogradin dhe thelloi kontradiktat me Rusinë. Dalëngadalë boshti i divergjencave dhe traktativave u zhvendos nga Shkodra në Gjakovë. Në këtë situatë konfrontuese ndërhyri diplomacia gjermane, e cila përmes ambasadorit gjerman në Londër Lichnowsky paraqiti një kundërpropozim kompromisi përmes të cilit synohej të gjendje një kompromis, që Ballplatzi të bënte një lëshim tjetër, duke hequr dorë nga Gjakova. Në të kundërtën, shanset për të mbajtur Shkodrën për Shqipërinë bëheshin të vështira. Për më tepër, Gjermania nuk ishte e gatshme që ta ndiqte verbërisht politikën e Vjenës dhe të mos vihej në rrezik gjithë suksesi i bisedimeve të ambasadorëve dhe afrimi gjermano-anglez, për të cilin angazhohej ambasadori Lichnowsky. Në fakt gjatë Konferencës së Londrës ambasadori austro-hungarez Mensdorff dhe ambasadori gjerman, Lichnowsky nuk kishin gjithmonë një qëndrim të unifikuar. Mensdorff ishte ankuar në Vjenë për këtë çështje, ndërsa Lichnowsky u qortua nga Ministria e Jashtme gjermane. Në të njëjtën kohë, kriza e Shkodrës dhe çështje shqiptare shpërfaqën dallimet që ekzistonin në mes Perandorit gjerman Wilhelmi II dhe Zyrës së Kancelarit. Në përgjithësi, Gjermania ishte e kënaqur me udhëheqjen e Grey-t, por hezitimi i tij për të miratuar masa për largimin e malazezëve nga Shkodra solli kritika nga pala gjermane.¹⁹ (Auf dem Wege zum Abgrund, I, 103-4).

Në përgjithësi, Gjermania ishte e kënaqur me udhëheqjen e Grey-t, por hezitimi i tij për të miratuar masa për largimin e malazezëve nga Shkodra solli kritika (G.P., XXXIV, ii, nr. 13252, shënim anësor, 13254; për një kritikë të përgjithshme shih, XXXIV, i, nr. 12561, shënim).

Zgjidhja e çështjes shqiptare njëkohësisht nxori në pah mospërputhjen e vizioneve politike të Wilhelmit të II dhe qeverisë së tij, duke përforcuar mendimin se politika dhe diplomacia e shtetit gjerman nuk ishin në harmoni me njëra-tjetrën në lidhje me këtë problem.

Çështja shqiptare dhe pozicioni i Gjermanisë

NË vitin 1912 çështja e pavarësisë së Shqipërisë u përshpejtua nga zhvillimet dramatike në Ballkan: humbja e befasishme e luftës nga ana e Perandorisë Osmane dhe fitore e vendeve të Aleancës Ballkanike rrezikuan ekzistencën e territoreve shqiptare. Diplomacia evropiane ndërmori nismën diplomatike për organizimin e një konference ndërkombëtare e cila duhej të zgjidhje problemet mes shteteve aleate ballkanike dhe Perandorisë Osmane.

¹⁹ Fürst Lichnowsky, Auf dem Wege zum Abgrund : Londoner Berichte, Erinnerungen und sonstige Schriften. Dresden : C. Reissner, 1927, I, 103-4.

Në këtë kontekst, objekt trajtimi u bë edhe çështja shqiptare, përkatësisht njohja e kërkesës së shqiptarëve për pavarësi, që deri atëherë nuk e kishte pasur vëmendjen e duhur. Për çështjen shqiptare ishin tri fuqi evropiane që kishin interesim: Austro-Hungaria, Italia dhe Gjermania, të cilat përbënin Aleancën Trepalëshe përballë tri shteteve të Antantës, Franca, Rusia dhe Britania e Madhe, të cilat kryesisht anonin kah Aleanca Ballkanike. Pra, interesat e tyre shinin kontradiktore dhe për gjatë gjithë Konferencës së Londrës ato ishin të pranishme.

Në rrethanat e reja të krijuar nga shpërbërja e Perandorisë Osmane në Ballkan, fati i Shqipërisë do të varej nga mbështetja e Austro-Hungarisë, e cila ishte kundër zgjerimit të territorial të Serbisë mbi territoret shqiptare. Vjena e shihnte një Shqipërisë të pavarur si një barrierë të ardhshme që do të pengonte shtrirjen e “sllavizmit” në Ballkan, veçanërisht daljen e Serbisë ë Adriatikut shqiptar. Ndërsa Gjermania, e cila nuk shpërfaqte ndonjë interes të veçantë, ishte e predispozuar të ndiqte qëndrimin e Austro-Hungarisë. Edhe Italia ishte kundër daljes serbe në Adriatik, pasi ajo e konsideronte si sferë të interesit italian.

Në këtë rrethanë kishte rrezik për konfrontim të të mëdhenjve. Rreziku u ndje kur Gjermania deklaroi në fillim të dhjetorit se në rast të një sulmi kundër Austro-Hungarisë, Berlioni do të përmbushte detyrimet që rridhnin nga Aleanca Tripalëshe.²⁰

Lichnowsky pohoi se Gjermania mbështeti Austro-Hungarinë dhe Italinë për Shqipërinë dhe çështjet kufitare, ndërsa Sir Edward Grey ndihmoi në shmangien e një konflikti të parakohshëm duke lehtësuar largimin e Mbretit Nikita nga Shkodra. Pa këtë ndërhyrje, kriza mund të kishte çuar në një luftë botërore që në atë kohë.²¹

Lufta e Parë Ballkanike kishte çuar në shembjen e shpejtë të Perandorisë Osmane dhe kështu në një humbje për politikën gjermane, e cila kishte qenë e lidhur ngushtë ekonomikisht dhe ushtarakisht me Perandorinë Osmane për një periudhë të caktuar kohe. Në prag të Konferencës së Londrës, Fuqitë e Mëdha u morën vesh që në një konferencë të tillë të diskutoheshin çështjet e riorganizimit të Perandorisë Osmane të cilat pas luftës do të zgjidheshin. Sipas propozimeve të konferencës, Perandoria Osmane duhej të hiqte dorë nga territoret e saj evropiane, përveç një zone të ngushtë rreth Kostandinopojës/Stambollit.²²

Një çështje që, sipas ambasadorit gjerman në Vjenë, më 3 janar, do të vazhdonte të shqetësonte diplomacinë dhe do të duhej trajtuar me shumë kujdes, ishte çështja shqiptare. Ai parashikonte se do të kërkohej përpjekje dhe trajtim i matur për të shmangur që Shqipëria, e shndërruar tashmë në një shtet

²⁰ Puto, Arben, Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912[1914, Tiranë 1978, f.144.

²¹ Prince Lichnowsky, My mission to London, 1912-1914, , f.11.

²² Tutenber, Volker, Die deutsche Mittelmeer-Division und die Londoner Botschafterkonferenzen, Diss. 2Diss. Universitöt Karlsruhe, 1987, f. 95.

autonom, të mos kthehej në mollë sherri midis dy shteteve më të interesuara, Austro-Hungarisë dhe Italisë. Në lidhje me pyetjet mbi qëndrimin gjerman, ambasadori gjerman Tschyrsky në Vjenë iu përgjigj pyetjeve të kontit Berchtold se Gjermania ishte e paimpërsuar dhe do të binte dakord, për çfarë bien dakord në Vjenë dhe Romë.²³ Këto probleme u diskutuan me ministrin e jashtëm britanik Grey dhe ambasadorin gjerman në Londër, Princin Lichnowsky. Ai e dinit gjithashtu se do të ishte shumë e vështirë, të arriheshin kompromise. Ai shpresonte se “kancelari gjerman tani ishte i vetëdijshëm për sa serioze është vështirësia dhe se ai do të përdorë gjithë ndikimin e tij në Vjenë për të nxitur një zgjidhje.”²⁴ Ambasadori gjerman Lichnowsky shpjegonte se këmbëngulja e palëkundur e austriakëve lidhej me bindje e tyre se, në rrethanat e caktuara, mund të vinte deri te lufta - një mendim “që nga këndvështrimi austriak duket i kuptueshëm, nëse atje mendojnë se mund të disponojnë pa kushte fuqinë tonë.”²⁵ Lichnowsky në raportin që i dërgon kancelarit perandorak, Bethmann Hollweg, thekson se nga deklaratat e Kontit Benckendorff, është shumë e qartë se qeveria ruse dëshiron të arrijë një sukses në çështjen e kufirit shqiptar, jo vetëm për shkak të imazhit të saj ndërkombëtar, por edhe për shkak të simpativë ortodokse dhe sllave.²⁶ Në të njëjtën kohë, Vjena zyrtare e konsideronte zhgënjyes faktin nëse Rusia në Londër do ia dilte për të paraqitur Austro-Hungarinë si prishësen e paqes.²⁷

Zhvillimi i mëtejshëm i krizës tani varej nga pozicioni i Gjermanisë. Politika e Bertholdit për frikësimin e Serbisë, bazohej në mbështetjen politike që ai priste në vazhdimësi nga Perandoria Gjermane. Kancelari i Rajhut gjerman, Bethmann Hollweg-u dhe Sekretari i tij i shtetit për punë të jashtme, Kiderlen-Wächter, donin ta përkrahnin ushtarakisht qeverinë vjenazë në rast të një sulmi rus. Berlioni kishte interesa ta ruante Austro-Hungarinë si një Fuqi të Madhe, por njëkohësisht nuk ishte i gatshëm të futej në luftë kundër Rusisë për një port serb në Adriatik.²⁸ Por, edhe Rusia në fund të nëntorit 1912 nuk donte të përzihej në një luftë eventuale për një port serb në Adriatik.²⁹ Në këto rrethana Gjermania, ngjashëm si në luftërat e viteve 90-të të shekullit 20 në Jugosllavi, luante rolin e një ndërmjetësuesi midis qëndrimeve austro-

²³ Tutenber, Volker, Die deutsche Mittelmeer-Division und die Londoner Botschafterkonferenzen, f.95-96.

²⁴ Tutenber, Volker, Die deutsche Mittelmeer-Division und die Londoner Botschafterkonferenzen, f. 96.

²⁵ GP 34, I, Nr. 12740, Der Botschafter in London Fürst von Lichnowsky an Reichskanzler von Bethmann Hollweg Ausfertigung Nr. 42 Geheim Nr. 101* London, den 22. Januar 1913.

²⁶ GP 34, I, Nr. 12740, Der Botschafter in London Fürst von Lichnowsky an Reichskanzler von Bethmann Hollweg Ausfertigung Nr. 42 Geheim Nr. 101* London, den 22. Januar 1913.

²⁷ GP 34, I, Nr. 12740, Der Botschafter in London Fürst von Lichnowsky an Reichskanzler von Bethmann Hollweg Ausfertigung Nr. 42 Geheim Nr. 101* London, den 22. Januar 1913.

²⁸ Löhr, Hanns Chrtisna, Hanns Christian Löhr: Die Gründung Albaniens. Eilhelm zu Eied und die Balkan-Diplomatie der Großmächte 1912–1914. Peter Lang 2010, f. 41.

²⁹ Po aty.

hungareze dhe atyre ruse me qëllim që të evitohej një përplasje ushtarake evropiane.

Pasi Perandoria Osmane në Evropë nuk mund të shpëtohej më, sipas ambasadorit gjerman në Londër, Lichnowskyt, kishte dy mënyra se si mund ta trajtonim trashëgiminë:

“... ose Gjermania të shpallte një mosinteresim të plotë lidhur me përcaktimin e kufijve dhe t'u lëmë Fuqive Ballkanike ta zgjidhnin ato vetë, ose mund të mbështeste “Aleatët” e saj dhe të vazhdonte me një politikë të Aleancës së Trepalëshe në Lindjen e Afërt, duke hequr dorë nga roli i ndërmjetësit.³⁰

Në këtë kontekst, pika kyçe ishte çështja shqiptare. Aleatët e Gjermanisë dëshironin krijimin e një shteti të pavarur shqiptar, pasi austriakët nuk donin që serbët të kishin qasje në Adriatik, ndërsa italianët ishin kundër që grekët të arrinin në Vlorë apo edhe në veri të Korfuzit. Kundër kësaj, Rusia, siç dihet, mbështeste synimet e Serbisë dhe Franca ato të Greqisë.³¹ Lidhu me këtë problematik, ambasadori gjerman në Londër, princi Lichnowsky e këshillonte Berlinin që kjo çështje të trajtohet jashtë kuadrit të Aleancës dhe të mos mbështeteshin kërkesat as të Vjenës dhe as të Romës. “Pa ndihmën tonë, do të kishte qenë e pamundur të krijohet një Shqipëri e pavarur, e cila, siç mund ta parashikonte kushdo, nuk kishte mundësi për të mbijetuar; Serbia do të kishte shtrirë kufijtë e saj deri në det, dhe lufta e tanishme botërore do të shmangej,”³² thotë Lichnowsky.

Në sfondin e këtyre ngjarjeve, sekretari gjerman i shtetit Jagow, më 15 mars 1913 e këshilloi qeverinë e Vjenës që të propozonte një protestë në mbledhjen e ardhshme të ambasadorëve në Londër. Fuqitë evropiane duhet të dënonin masakrat e Malit të Zi dhe të Serbisë ndaj shqiptarëve në Kosovë dhe më gjerë. Por përpjekja gjermane dhe austriake në mbledhjen tjetër të Konferencës mbeti pa sukses. Prandaj, Bertholdi mendoi që Austro-Hungaria të largohej nga Konferenca e Ambasadorëve. Pos të tjerash, ai kërkoi të merreshin masa ushtarake ndaj Serbisë dhe Malit të Zi. Në anën tjetër Sekretari gjerman i shtetit, Jagow, një aksion të tillë e konsideronte si një prishje e rrezikshme marrëdhënies me fuqitë të tjera evropiane. Qeveria gjermane paralajmëroi Vjenës që të mos ndërmerrej një hap i tillë, pasi përgjegjësia për dështimin e Konferencës së Ambasadorëve do të binte mbi Aleancën Trepalëshe. Prandaj, ministri i jashtëm austro-hungarez Berchtold përkohësisht hoqi dorë nga një ndërhyrje ushtarake. Përpjekja e Berlinit për ta ruajtur Koncertin Evropian ishte në të njëjtën linjë me ministrin e Jashtëm anglez, Grej, i cili po ashtu dëshironte ta ruante Konferencën e Ambasadorëve si një “*clearing-house*” evropiane.

³⁰ Princi Lichnowsky, Prince, My Mission 1912-1914. Neë York, George H. Doran Company, 1918, f. 6.

³¹ Lichnowsky, Prince, My Mission to London 1912-1914. Neë York, George H. Doran Company, 1918, f. 6.

³² Lichnowsky, Prince, My Mission to London 1912-1914., f. 6.

Çështja e Adriatikut

Në Luftën e Parë Ballkanike (1912-1913), Mali i Zi, Serbia, Bullgaria dhe Greqia së bashku dëbuan osmanët nga e gjithë rajoni i Ballkanit dhe rajoni midis Detit Mesdhe dhe portit të Selanikut në Egje. Megjithatë, ata nuk mundën të bien dakord për ndarjen e territoreve të pushtuara. Midisi 22 dhe 28 nëntorit divizionet e ushtrisë serbe u futën në gjysmën veriore të Shqipërisë deri në Adriatik. në Shqipëri deri në Adriatik.³³

Kur Sekretari i Shtetit në Ministrinë e Jashtme të Gjermanisë, Kiderlen Wächter i kishte tërhequr vëmendjen diplomatit serb se Serbia mund të siguronte një dalje në det në anën e Egjeut, ndërsa në Adriatik do të hynte në konflikt me Austro-Hungarinë dhe Italinë, i dërguari serb ishte përgjigj se, sipas marrëveshjes mes shteteve ballkanike, bregdeti i Egjeut ishte tashmë i ndarë dhe Serbia ishte orientuar drejt Shqipërisë. Ky plan i ishte paraqitur Ruisë, dhe pritej miratimi i saj. Serbët ishin të bindur se nëse Austro-Hungaria do të kundërshtonte aneksimin e Shqipërisë nga Serbia, atëherë jo vetëm Bullgaria, por edhe Rusia do të mbështesnin Serbinë. Besimi i serbëve në ndihmën ruse u reflektua edhe në pyetjen e tyre nëse Gjermania do të mbështeste Austro-Hungarinë kundër Ruisë, edhe nëse Franca do të qëndronte neutrale.³⁴ I njëjti instruksion i ishte dërguar edhe në ambasadave në Romë, Paris, Londër dhe Shën Petersburg. Por, në urdhrat e dërguar në Paris dhe Londër, në vend të paragrafit të fundit, ishte përfshirë: “Ju lutem të tërhiqni në mënyrë krejtësisht konfidenciale vëmendjen e qeverisë përkatëse ndaj rrezikut që paraqesin planet serbe, veçanërisht nëse ato mbështeten nga disa përfaqësues rusë.”³⁵

Kur sekretari gjerman i shtetit për punë të jashtme Kiderlen u pyet nga i dërguari serb Bokiqeviç se si do të vepronte Gjermania në rast të një konflikti midis Ruisë dhe Austro-Hungarisë, veçanërisht nëse Franca do të solidarizohej me Rusinë, u përgjigj, sekretar gjerman i shtetit kishte deklaruar se deklaroi se Gjermania nuk besonte në mundësinë e izolimit të konfliktit ballkanik dhe se, nëse shpërthente një luftë midis Ruisë dhe Austro-Hungarisë, ajo do ta konsideronte këtë një casus foederis për të mbështetur Austrinë, edhe nëse Franca qëndronte neutrale. Ai theksoi se fuqitë e Traktatit Trepalësh nuk kishin synim të pengonin zgjerimin e shteteve ballkanike, por e konsideronin

³³ Hall, C. Richard, *The Balkan wars, prelude to the First World War*, London 2000, f. 66.

³⁴ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette, 1871-1914 : Sammlung der diplomatischen akten des Auswärtigen amtes, im auftrage des Auswärtigen Amtes, 33- Nr. den 12338 Der Staaßsekretär des Auswärtigen Amtes von Kiderlen an Botschafter in Wien von Tschirschky-Telegramm. Nr. 137 Der serbische Eigenhändiges Konzept Berlin, den 7. November 1912.

³⁵ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette, 1871-1914: 33- Nr. den 12338 Der Staaßsekretär des Auswärtigen Amtes von Kiderlen an Botschafter in Wien von Tschirschky-Telegramm. Nr. 137 Der serbische Eigenhändiges Konzept Berlin, den 7. November 1912.

një kërcënim për interesat e tyre një dalje të Serbisë në Adriatik. Në vend të kësaj, ata do ta mbështesnin Serbinë për të siguruar një dalje në Egje, duke përfshirë edhe mundësinë e pushtimit të Selanikut.³⁶

Poincaré pranon qartë në kujtimet e tij (*Au Service de la France II, f. 318*) se më 7 nëntor kishte marrë telegrame të gjata nga Berlioni, të cilat, megjithëse konfirmonin vendosmërinë e Austro-Hungarisë për të mos lejuar Serbinë të kishte dalje në Adriatik dhe mbështetjen e Gjermanisë për këtë qëndrim, i krijuan atij njëfarë shprese për një mirëkuptim (un espoir d'entente). Ai nuk e pa këtë qëndrim të fuqive qendrore si një kërcënim për paqen botërore, aq sa për një moment la mënjanë shqetësimet e tij lidhur me ambiciet ekspansioniste të Austrisë, të cilat i kishte shprehur më parë ndaj Iswolsky.³⁷ Në këto rrethana, më 8 nëntor 1912, Edward Grey shprehu mendimin se, nëse çështja e një porti serb në Adriatik ishte bërë një pengesë kryesore, e cila do të jetë e nevojshme të shqyrtohen motivet që qëndrojnë pas kundërshtimit të Austro-Hungarisë dhe kërkesës së Serbisë. Grey mendonte se nuk ishte e pamundur të gjendej një zgjidhje që do të largonte shqetësimet e Austro-Hungarisë dhe do t'i siguronte Serbisë thelbin e asaj që dëshiron.³⁸

Zhvillimi i mëtejshëm i krizës tani varej nga qëndrimi i Gjermanisë. Politika e Berchtoldit për kërcënimin e Serbisë, bazohej në mbështetjen politike që ai kishte pasur deri tani nga Berlioni. Kancelari gjerman, Bethmann Hollweg dhe sekretari i tij i shtetit për punë të jashtme, Kiderlne Wächter, donin ta përkrahnin ushtarakisht qëndrimin e qeverisë austro-hungareze vetëm në rast sulmi rus. Për Gjermaninë ishte me interes që Austro-Hungaria të ekzistonte si një Fuqi e Madhe. Por njëkohësisht Berlioni nuk ishte i gatshëm të futej në një luftë kundër Rusisë për një port serb në Adriatik.³⁹ Nga ana tjetër, edhe Rusia nuk donte të përzihej në një luftë për një port serb në Adriatik. Edhe Franca dhe Anglia nuk i kishin deklaruar një përkrahje

³⁶ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette, 1871-1914 : 33- Nr. den 12338 Der Staaßsekretär des Auswärtigen Amtes von Kiderlen an Botschafter in Wien von Tschirschky-Telegramm. Nr. 137 Der serbische Eigenhändiges Konzept Berlin, den 7. November 1912.

³⁷ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette, 1871-1914 : 33- Nr. den 12338 Der Staaßsekretär des Auswärtigen Amtes von Kiderlen an Botschafter in Wien von Tschirschky-Telegramm. Nr. 137 Der serbische Eigenhändiges Konzept Berlin, den 7. November 1912.

³⁸ Sipas Sir Edward Grey, kundërshtimi i Austro-Hungarisë mund të rrjedhë nga frika se vendosja e një baze detare në Adriatik mund të bjerë përfundimisht nën ndikimin e një Fuqie të Madhe, qoftë Rusia apo një shtet ballkanik i federalizuar. Nga ana tjetër, kërkesa e Serbisë ndoshta nuk ka motive detare, por synon një dalje të pavarur ekonomike. Nëse kjo analizë është e saktë dhe nëse motivet e Austro-Hungarisë dhe Serbisë kufizohen vetëm në këto çështje, të cilat janë të thjeshta dhe natyrore nga të dyja palët, Sir Edward Grey mendon se nuk duhet të jetë e pamundur të gjendet një zgjidhje që do të largonte shqetësimet e Austro-Hungarisë dhe do t'i siguronte Serbisë thelbin e asaj që dëshiron. Shih: Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette, 1871-1914: 33- Nr. den 12338 Der Staaßsekretär des Auswärtigen Amtes von Kiderlen an Botschafter in Wien von Tschirschky-Telegramm. Nr. 137 Der serbische Eigenhändiges Konzept Berlin, den 7. November 1912.

³⁹ Hanns Christian, Löhr, Die Gründung Albaniens, f.41.

ushtarake Rosisë në çështjen e Ballkanit. Për këtë arsye, Sazanovi u angazhua për t'i mos dhënë pritje të larta Serbisë. Kështu Fuqitë e Mëdha shpërfaqën gjithnjë e më shumë qëndrime për të mos hyrë në kurrfarë lufte për shkak të një porti serb në Adriatik. Me këtë u hap rruga që Koncerti Evropian të vepronte së bashku.⁴⁰

“Deri më tani ka pasur vetëm deklarata jodetyruese nga z. Pashiq, por këto justifikojnë përfundimin se Beogradi është i gatshëm të tregojë anë më të buta ndaj monarkive fqinje”, shton ambasadori gjerman, Lichnowsky, duke shtuar se Vjena akoma nuk ishte hyrë në biseda të drejtpërdrejta me Beogradin. Por, në këtë dokument thuhej qartë se “Në çdo rast, duhet të pritët një zgjerim territorial i Serbisë. Dhe një provë për sinqeritetin e synimit të Serbisë për të mbajtur marrëdhënie të mira me Austrinë do të ishte nëse Beogradit i kërkonte apo jo një port në detin Adriatik”.

Më tej diplomati gjerman, duke paraqitur pikëpamjet e Vjenës zyrtare, vinte në dukje se “nëse dëshiron portin e saj buzë detit shqiptar, në të cilin mund të shkojë vetëm me ndihmën e një treni që kushton rreth 300 milionë franga përmes territorit të Shqipërisë dhe për të cilin duhet ta ketë parasysh se Austria nuk mund të pajtohet me të, atëherë kjo do të tregonte se nuk dëshiron të heqë dorë nga politika e vjetër e mosbesimit ndaj Austrisë”.

Për më tepër, më 18 nëntor 1912, perandori austro-hungarez Franc Josephi I i mobilizoi edhe trupat në kufi me Rusinë. Një konflikt i tillë austro-rus do të kishte pasojë për Perandorinë Gjermane. Prandaj çështja e Adriatikut kërcënonte të shndërrohej në një luftë ndërmjet Antantës dhe Aleancës Trepalëshe. Zhvillimi i mëtejshëm i krizës tani varej nga qëndrimi i Gjermanisë. Politika e Berzholidit për trembjen e Serbisë, bazohej në mbështetjen politike që ai e priste nga Berlino. Kancelari i Rajhut gjerman, Bethman-Hollweg, dhe sekretari i tij i shtetit për punët e jashtme, Kiderlen-Wechter, dëshironin ta përkrahnin ushtarakisht qeverinë e Vjenës vetëm në rast të një sulmi rus. Pra, Berlino nuk ishte i gatshëm të futej në një luftë kundër Rosisë për një port serb në Adriatik. Prandaj, Perandoria Gjermane në fillim të krizës së Adriatikut, ashtu si Austro-Hungaria, ndërhyri që të ruante *status quo-në* në Ballkan. Më 25 nëntor 1912, Sekretari i shtetit gjerman, fon Kinderlen Wachter, publikoi një artikull gjysmëzyrtar në “Norddeutsche Allgemeine Zeitung”, në të cilin nënvizohej se qeveria austro-hungareze nuk do t'i kërkonte Serbisë në mënyrë ultimative të tërhiqej nga Adriatiku. Ashtu si Rusia që nuk ishte e gatshme që të hynte në një luftë evropiane për një portë detar të Serbisë, edhe Gjermania ia kishte bërë me dije Austro-Hungarisë që të tregojë e përmbajtur. Ndërsa Austro-Hungaria po mbronte Shqipërinë që po lindte, Rusia mbetej e interesuar për çështjen e ngushticave dhe fatin e Stambollit. Këto çështje kërkonin përsëri ndërmjetësimin e fuqive të mëdha evropiane, për të penguar një luftë

⁴⁰ Hanns Christian, Löhr, Die Gründung Albaniens, f.42.

mes vendeve të Aleancës Ballkanike dhe për të penguar hyrjen e ushtrisë bullgare në Stamboll.⁴¹ Më shumë artikulli theksonte, se duke pasur parasysh situatën e ndryshuar në Ballkan, çështja e së ardhmes së Shqipërisë duhej të zgjidhje nëpërmjet bisedimeve. Me këtë konstatim, sekretari gjerman i shtetit i caktoi kufijtë e qartë politik për Vjenën. Ai sinjalizoi se Perandoria Gjermane nuk do ta përkrahte politikisht një veprim ushtarak kundër Serbisë.

Për të njëjtën arsye, çështja e lidhjes së Serbisë me Adriatikut u bë ndër pikat tri pikat kryesore të Konferencës së Ambasadoreve në Londër. Lidhur me këtë çështje, Konferenca e Ambasadorëve unanimisht kishte miratuar propozimin e Rusisë:

“Qasja tregtare do të rezervohet për Serbinë nga një port i lirë dhe neutral i Shqipërisë, ku do të shkonte hekurudha ndërkombëtare nën kontrollin evropian dhe do të veprojë një kompani ndërkombëtare, ku do të ketë lirinë që të transportojë në transit të gjitha mallrat komerciale, përfshirë këtu edhe municionet dhe pajisje luftarake.”⁴² Sir Eduar Grei mendonte gjithashtu se ministri i Jashtëm gjerman Kiderlen-Wächter duhet të ushtronte ndikimin e tij mbi Vjenën për të bërë që qeveria austro-hungareze të zotohet për të qëndruar në pritje ndaj Serbisë. Rusia dhe Franca në koordinim përpiqeshin ta qetësonin Berlinin dhe Vjenën se pushtimet tokësore nga forcat e Aleancës Ballkanike do të ishin të përkohshme.” Të paktën nga Gjermani më vjen një shpresë mirëkuptimi, shkruante në kujtimet e tij presidenti dhe kryeministri i Francet Raymond Poincare, të cilën nuk dua të lë të më ikë, dhe i vë në dijeni Londrën e Shën Petersburgun. “Më 8 nëntor mora nga Berlini telegrame të gjata, nga të cilat del se: 1. Austria deklarohet e vendosur t’u ndalojë serbëve daljen tokësore në Adriatik; 2. Gjermania është e vendosur ta përkrahë aleaten e saj; 3. Përveç këtij moslejimi, Austria nuk ka ambicie për asnjë zgjerim tokësor dhe do të kënaqej me garancitë e avantazhet ekonomike; 4. Qeveria gjermane do të ishte e gatshme të bashkëpunonte me Rusinë mbi çështjen e Stambollit, nëse Rusia i pranonte mendimet e Austrisë. Qeveria gjermane madje shkonte deri te pranimi i përjashtimit të bullgarëve nga Adrianopoli, gjë që më duket në kohën e sotme të mos ketë më arsye. Z. Kiderlen e çmon se do të ishte kështu një balancim i drejtë në mes sakrificave të kërkuara prej Bullgarisë dhe prej Serbisë në interes të paqes evropiane,”⁴³ theksonte Poincare. Në këndvështrim të Parisit, në këtë gjendje më nuk ekzistonte asnjë shqetësim nga kërcënimi i zgjerimit tokësor të Austro-Hungarisë. Ato do të mund të rishfaqeshin veç në rast se qeveria franceze nuk do të mund të merrej vesh me qeverinë austro-hungareze mbi çështjen e Adriatikut.

⁴¹ Poincare, Raymond, Lufta e parë dhe dytë Ballkanike si dhe Konferenca e Londrës (1912-1913). Logos-A. Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2006, f. 291-192.

⁴² DGPEK 1871-1914, Band 37, Nr. 12545.

⁴³ Poincare, Raymond, Lufta e parë dhe dytë Ballkanike si dhe Konferenca e Londrës (1912-1913). Logos-A. Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2006, f. 306-307.

Nga kujtimet e Poincares mësojmë se lidhur me pretendimet e Serbisë për dalje në Adriatik, Kiderleni i Gjermanisë kishte propozuar në dalje të Serbisë në Egje, që sipas politikanit francez, ishte një po pozim që i ngatërronte serbët me bullgarët dhe grekët dhe në hedhje e Serbisë në një trevë ku nuk kishte popullsi serbe. Përveç kësaj, pretendohet se Rusia kurrë nuk i kishte garantuar Serbisë dalje në Adriatik.”⁴⁴ Në të vërtetë, vetë Izvolski, ambasador rus në Paris, e kishte siguruar udhëheqjen franceze se për portin serb, Rusia nuk kishte marrë vendim. Përveç kësaj. Ministri i Jashtëm rus Sergej Dmitrievič Sazanov deklaroi se kishte telegrafuar përfaqësuesit rus në Beograd për ta lutur që t’i rekomandonte Pashiqit qetësi dhe përmbajtje.⁴⁵ Në fund të nëntorit 1912, edhe Rusia nuk dëshironte të përzihej në një luftë evropiane vetëm për një port serb në Adriatik. Sazanov deklaronte se qeveria ruse nuk është e pirur t’i japë Serbisë asnjë ndihmë ushtarake si dhe ngulte këmbë që qeveria serbe të mos e lejonte ushtrinë të marshojë drejt Durrësit, duke u mbuluar me autoritetin e Rosisë, “me qëllim të mos verë përpara kërkesa, rrëzimi i të cilave do të lëndonte sedrën.”⁴⁶ Ky qëndrim kushtëzohet edhe nga roli që do të kishin dy fuqitë tjera të Antantës, Franca dhe Anglia, të cilat ende nuk kishin siguruar një përkrahje ushtarake për Parandorinë ruse në çështjen e Ballkanit. Prandaj, Rusia nuk mund të hynte në asnjë konflikt ushtarak me Austro-Hungarinë, prapa së cilës qëndronte Gjermania. Por, për shkak të “ndjenjave sllave” pohonte Sazanov, në rast se serbët arrijnë në det dhe në qoftë se Austria i sulmon, ai nuk mund t’i mbante rusët, me gjithë dashurinë e tij për paqe.⁴⁷

Në kontekstin e mbrojtjes së synimeve të Aleancës Ballkanike, të cilat njëkohësisht shënon një humbje të ndjeshme të pozicionit austro-gjerman në Ballkan dhe në Stamboll, Sazanov pohon se sukseset e serbëve, i kapërcyen edhe vetë shpresat e tyre, sigurisht edhe pse kishin synime e tyre për në det. Në këtë drejtim, vëmendja e serbëve ishte drejtuar para së gjithash në bregdetin e Shqipërisë, ku kishte disa porte, të cilat edhe se në të vërtetë nuk paraqisnin komoditet të madh, megjithatë mund t’i shërbenin qëllimeve serbe, duke siguruar atë liri eksporti të cilën serbët nuk do të mund ta arrinin kurrë, pa u çliruar njëherë e përgjithmonë nga kufizimet kufitare që përsëriteshin vazhdimisht nga ana e fqinjëve të tyre.”⁴⁸ Por, përpos kësaj përfaqësuesi rus në Beograd N.G: Hartvig bënte të njohur se kërkesat tjera të aleatëve ballkanikë

⁴⁴ Poincare, Raymond, Lufta e parë dhe dytë Ballkanike si dhe Konferenca e Londrës (1912-1913), f. 309.

⁴⁵ Poincare, Raymond, Lufta e parë dhe dytë Ballkanike si dhe Konferenca e Londrës (1912-1913), f. 310.

⁴⁶ Poincare, Raymond, Lufta e parë dhe dytë Ballkanike si dhe Konferenca e Londrës (1912-1913), f. 310- 311.

⁴⁷ Poincare, Raymond, Lufta e parë dhe dytë Ballkanike si dhe Konferenca e Londrës (1912-1913), f. 310.

⁴⁸ Sazanov, Sergej Dimitrievič, Kujtime, f. 100.

kishin të bënin me ndarjen e Shqipërisë në mes Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë, në të njëjtën kohë, Serbia pretendonte si pjesë të plaçkës së saj Shqipërinë e Veriut, me përjashtim të rajonit të Shkodrës, që i lihej Malit të Zi, me bregdetin detar nga Shëngjini deri në Shkumbin, duke i lënë Greqisë jugun e Shqipërisë. Këto kërkesa, shkruante Hartvig, fituesit ballkanik vendosën që t'i mbrojnë me armë në dorë.⁴⁹ Kuptohet vetvetiu se ndarja e Shqipërisë ndërmjet aleatëve ballkanas, në thelb, nuk ndeshte në kundërshtimi nga ana e Rusisë, duke pasur parasysh interesin rus për ta sfiduar Austro-Hungarinë në bregdetin Adriatik dhe Gjermaninë në Stamboll, ndërsa Anglinë në çështjen e ngushticave. E pranon edhe Sazanov se nuk kishte asnjë dyshim se çdo pretendim i aleatëve ballkanikë ndaj territorit shqiptar, do të shkaktonte menjëherë ndërveprimin më të vendosur nga ana e Austro-Hungarisë dhe Italisë, interesat e të cilave, për fat të keq të Serbisë, ishin identike në këtë pjesë të Gadishullit Ballkanik.⁵⁰

Konferenca e Ambasadorëve në Londër

Mjeti i vetëm për lokalizimin e luftës dhe për zgjidhjen e problemeve të shumta, që dolën në radhë të parë të lidhur me zhvillimin e veprimeve luftarake ishte organizimi i një konference ndërkombëtare. Që në fillim të Luftës Ballkanike, te drejtuesit e politikës së jashtme të Antantës u shfaq mendimin për një konferencë të tillë. Por, që nga koha e lindjes së idesë për një konferencë ndërkombëtare, ndryshoi kuptimi dhe formati i konferencës, në vend të një aparati voluminoz, shtetet e Antantës u pajtuan për organizimin e mbledhjes së ambasadorëve, në një nga qytetet evropiane. Për këtë qëllim, fillimisht u mendua Parisi, por për arsye të karakterit personal, që kishin humbur interesin e tyre, zgjedhja përfundimtare ra mbi Londrën.⁵¹

Ende përpara fillimit të punimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër nuk kishte dyshim në faktin se pika kryesore e konferencës, më shumë në fokus, në të cilën do të pasqyroheshin pikëpamjet vështirë të pajtueshme nëpërmjet tyre të shteteve të Antantës dhe Aleancës Trepalëshe, ishin problemi i krijimit të pandashëm të Shqipërisë së pavarur dhe lejimi i Serbisë për dalje në detin Adriatik.⁵² Këto dy probleme ministri i Jashtëm rus Sazanov i quante të pandashme, sepse Austro-Hungaria dhe Italia, për shkak të marrëdhënieve reciproke politike paradoksale të tyre, u morën vesh lidhur me domosdoshmërinë për të rënë dakord për krijimin e shtetit të pavarur të Shqipërisë.” Sido që ky shtet pak vital, as njëra dhe as tjetra nga të dy fuqitë e mëdha të Adriatikut, nuk i lëshonin palës tjetër mbizotërimin e situatës në bregdetin e Shqipërisë. Këtij këndvështrimi menjëherë iu bashkua dhe Gjermania dhe

⁴⁹ Sazanov, Sergej Dimitrievič, Kujtime, f. 100.

⁵⁰ Sazanov, Sergej Dimitrievič, Kujtime, f. 100.

⁵¹ Sazanov, Sergej Dimitrievič, Kujtime, f. 101.

⁵² Sazanov, Sergej Dimitrievič, Kujtime, f. 104.

me këtë i dha më shumë peshë.⁵³ Një qëndrim armiqësor të të gjitha shtetet e Aleancës Trepalëshe shkaktonte edhe mundësia e shfaqjes së Serbisë në Shëngjin ose në Durrës.

Në këtë rrethanë, e cila ishte e pamundur që të mos merrej parasysh nga qeveria ruse dhe miqtë e saj, ishte paracaktuar përfundimi jo i favorshëm i synimeve të shtuara të popullit serb për të siguruar dalje në bregdetin më të afërte dhe në këtë mënyrë, të shkundë nga vetja varësinë ekonomike nga fqinjët jo dashamirës. “Unë e thashë se simpatia unanime e qeverisë dhe shoqërisë ruse ishin në anën e Serbisë. Në fillim të vitit 1913, simpatia e opinionit tonë shoqëror për pretendimet e serbëve filloi të shfaqej më fortë, e cila ma futi frikën lidhur me mundësinë për të mbajtur në duart e qeverisë ndikimin udhëheqës në zhvillimin e ngjarjeve politike”,⁵⁴ shkruan Sazanov.

Veçanërisht për përpjekjet e Perandorisë Austro-Hungareze dhe Rusisë për të ndikuar në ndarjen e territoreve në Ballkan. Në shkurt të vitit 1913, Princi Hohenlohe mbërriti në Shën Petersburg me një letër personale nga Perandori Franz Joseph drejtuar carit rus. Në këtë kontekst, Austria bëri disa lëshime lidhur me kufirin në Gjakovë, ndërsa Rusia u tregua e gatshme për kompromis. Megjithatë, ministri i jashtëm Sazanov, mendonte se qyteti i Shkodrës mund t’i jepej Malit të Zi vetëm nëse Serbia e merrte Dibrën dhe Gjakovën, bashkë me liqenin e Shkodrës dhe rrethinat e tij.⁵⁵ Javët në vijim sollën një lëvizje të vazhdueshme përpara dhe prapa në negociata. Sazanovi duhej të këmbëngulte për Gjakovën, për të ruajtur prestigjin rus, ndërsa Berchtold dëshironte me çdo kusht atë si pjesë të Shqipërisë.⁵⁶ Propozimet e Grey-it për një Komision ndërkombëtar, që do të përcaktonte përkatësinë e këtij qyteti, gjithashtu nuk çuan në ndonjë rezultat. Por, më vonë Berchtold, i cili më pas u dha. Zgjidhja e krizës së Shkodrës ishte e bllokuar, dhe Shkodra për Austro-Hungarezët ishte shumë e rëndësishme. Berchtold ishte i gatshëm të paguante çmimin e kërkuar nga Rusia, nga kjo ai priste:

1. Që të arrihet një vullnet i përbashkët i fuqive evropiane lidhur me kufizimin e Shqipërisë së Veriut dhe të njoftoheshin shtetet ballkanike për këtë, me qëllim që të parandalohesh pushtimi dhe marrja e Shkodrës, së bashku me të gjitha pasojat e mundshme (masakra të banorëve, mosdorëzimi i Shkodrës, etj.)

2. Që Shkodra dhe rrethina e saj të njëjhej si pjesë e Shqipërisë nga e gjithë Evropa, madje edhe nëse do të ndodhte pushtimi i saj, sipas kufijve të dëshiruar nga Austro-Hungaria (Buna, brigjet e liqenit të Shkodrës);

⁵³ Sazanov, Sergej Dimitrievič, Kujtime, f. 104.

⁵⁴ Sazanov, Sergej Dimitrievič, Kujtime, f. 104.

⁵⁵ Krause, adalbert Gotfried, DAs Problem der albanischen Unabhangikeit in den Jahren 1908-1914. Phil. Diss. Uni Whohenien, 1970, f. 233 Krause, adalbert Gotfried, DAs Problem der albanischen Unabhangikeit in den Jahren 1908-1914. Phil. Diss. Uni Ehohenien, 1970, f. 235.

⁵⁶ Ö. U. A, Bd. V, Nr. 6160. Por, më vonë

3. Që të pranohet një marrëdhënie e pranueshme e Austro-Hungarisë dhe Serbisë në tërësi.⁵⁷

Arsyet e lëshimit të Austro-Hungarisë ishin pjesërisht të natyrës humanitare - vetëm vendimi i shpejt i fuqive evropiane mbi kufijtë e Shqipërisë dhe ndërhyrja e tyre në mbrojtjen e minoriteteve katolike dhe shqiptare mund t'i ndalonte mizoritë serbo-malazeze. Një vendim i tillë mund të arrihej vetë, duke hequr dorë nga Gjakova.

Por, mbi të gjitha, ishte njohja e situatës politike të krijuar. Pasi ishte marrë vendimi se nuk mund të lejohej një luftë me Rusinë, por nga ana tjetër, për arsye prestigji, Serbia këmbëngulte absolutisht për aneksimin e Gjakovës, praktikisht nuk kishte rrugë tjetër për të dalë nga bllokimi diplomatik ku ishte futur çështja shqiptare.⁵⁸

Në të vërtetë, ishte e qartë se në qoftë se Rusia në këtë moment do të vendoste të shkonte më tej se mbështetja diplomatike që i jepte Serbisë bashkë me aleatët e saj, asaj do t'i duhej ta bënte këtë vetëm me forcat e veta dhe duke marrë përgjegjësinë dhe rrezikun vetë, sepse as Franca dhe as Anglia nuk do të ishin në anën e saj për të mbrojtur interesat e huaja dhe pak të qarta për ta.⁵⁹ Ministri i jashtëm francez Raymond Poincaré gjithashtu nuk ishte i gatshëm që t'i përballonte politikisht kërkesat serbe. Më 11 dhjetor ai kërkoi që Serbia duhet t'i nënshtrohej “vendimeve të Fuqive të Mëdha” në lidhje me hyrjen në Adriatik.⁶⁰

Por behej gjithnjë e më e qartë se shumica e shteteve evropiane ishin për të ruajtur “ekuilibrit klasik të fuqive” në Evropë, i cili veçanërisht që nga koha Bismarck-ut, kishte qenë një përbërës thelbësor i diplomacisë evropiane të fuqive evropiane.⁶¹ Në anën tjetër, në Aleancën Trepalëshe, Italia konsiderohej me njëfarë mosbesimi për shkak të ndjenjave të vjetra armiqësore midis Austro-Hungarisë dhe Italisë, pjesërisht për shkak të interesave të kundërta të këtyre dy vendeve në Gadishullin Ballkanik dhe, deri diku, për shkak të ndjenjës që po përhapej në disa rrethe në Vjenë dhe në Berlin se italianët e merrnin Traktatin Trepalësh ushtarak gjerman e udhëhequr nga Perandori, dhe ndërkohë që Anglia e ndiente kërcënimin përmes programit të përshpejtuar të ndërtimit të anijeve luftarake, të cilat rrezikonin dominimin e saj jetik mbi detin, burrat e shteteve evropiane ishin të interesuar të përqendroheshin në një zgjidhje tjetër për cepin juglindor të Gadishullit Ballkanik, ku ende nuk kishte ndonjë arsye të fortë për të hyrë në një luftë evropiane për shkak të një porti serb në Adriatik.

⁵⁷ Hantsch, Berthold, f. 398.

⁵⁸ Krause, Adalbert Gotfried, *Das Problem der albanischen Unabhängigkeit in den Jahren 1908-1914*, f. 236.

⁵⁹ Sazanov, Sergej Dimitrievič, Kujtime, f. 104.

⁶⁰ Löhr, Hanns Christian, *Die Gründung Albanians. Wilhelm zu Wied und die Balkan-Diplomatie der Grossmächte 1912/1914*. Frankfurt a. M.: Lang 2010. f. 39.

⁶¹ Krit, Robert, *Die Londoner Botschafter Konferenz 1912-1913*, Phil. Diss., Eien 1960, f. 4.

Si rrjedhojë u hap rruga për një angazhim diplomatik të Fuqive të Mëdha dhe u dha ideja se Koncerti Evropian duhej të vepronte me rrugë diplomatike për të evituar në luftë e cila do të çonte në konfrontim mes shteteve anëtare të Antantës dhe Aleancës Trepalëshe

Tani, përpara Luftës Ballkanike, në bisedimet e Fuqive të Mëdha u shfaq ideja që të këshilloheshin në një konferencë të tyrin për kërkesat e Aleancës Ballkanike pas reformave në pjesën evropiane të Perandorisë Osmane. Kështu me 13 tetor në Berlin, qeveria franceze propozoi projektin e saj për një konferencë në Kostandinopojë, e cila sipas traditës së konferencave të ambasadorëve të zhvilluara atje më parë, duhet të diskutonin mbi reforma të tilla.

Pjesëmarrja e të gjitha fuqive të interesuara, por në Berlin Kiderlen, të cilit ambasadori Cambon i kishte folur haptas për qëllimet franceze, iu përgjigj: “Po një konferencë, pa dyshim. Vetëm do të duhej të jetë e mundur të mbetej midis nesh, Fuqive të Mëdha.” Në anën tjetër qeveria franceze nuk ishte për një ide të tillë, ajo ishte e mendimit se do të ishte e dëshirueshme të pranohej, konkretisht e shteteve ndërluftuese dhe Rumanisë. Këtë qëndrim Franca do ja bënte të njohur edhe palës gjermane.⁶² Kiderlen Wächter në instruksionet e tij që i ambasadorit gjerman në Vjenë, Tschirschky, më 17 tetor theksohet se qëndrimi që mbante konti Berthold në lidhje me ndërmjetësimin dhe propozimin francez për organizimin e një konference përputhej plotësisht me atë që vërejmë ndaj sugjerimeve të zotit Poincare. Siç e keni parë edhe në dekretin e djeshëm 12275, që ju e keni marrë tani, ne kemi vendosur një trajtim zvarritës për idenë e konferencës, gjë që nuk na pëlqen.⁶³ Në këtë komunikim, Kiderlen më tutje thekson se nëse konferenca megjithatë nuk mund të shmanget ndërsa ngjarjet vazhdojnë, ajo në çdo rast duhet të përgatitet në detaje përmes një shkëmbimi paraprak idesh midis fuqive në mënyrë të tillë që pas të saj të funksionojë vetëm si një konferencë regjistrimi.

Në këtë rrethanë, kur shumica e vendeve evropiane, duke përfshirë dhe Gjermane, e ndjenin rrezikun e një lufte evropiane, ishte e qartë se Berlioni nuk ishte i gatshëm ta ndiqte palën austro-hungareze në përpjekjet e saj për krijimin e një Shqipërisë të pavarur dhe të kundërshtimit të saj për daljen e Serbisë në detin Adriatik, nëse ky hap do të çonte në një luftë evropiane. Kështu Wilehlstarsse, e cila i druhej një lufte, pres së cilës përfitimet nuk do të ishin aq të mëdha sa rreziqet, në të vërtetë ishte e prirë të jetë pak a shumë e matur. Ajo tregonte simpatinë për aleatën e saj, Austro-Hungarinë, por në prapaskenë, bënte përpjekje energjike për ta përmbajtur. Këtë gjë e shpreh saktësisht një fjalë, e sekt apo jo, që ia veshin perandorit gjerman: “Kujdes, i ka thënë ai kryedukës trashëgimtar të Austrisë, gjatë takimit të tij të fundit, ju

⁶² Poincare, Raymond, Lufta e parë dhe e dytë Ballkanike si dhe Konferenca e Ambasadorëve, f. 340-341.

⁶³ GP 33. Nr. 12280, Der Staatssekretär des Auswärtiges von Kiderlen an den Botschafter in Eien von Tschirschky, Berlin, den 17 Oktober 1912.

bëni shumë zhurmë me shpatën time.”⁶⁴ Realisht në këtë kohë në Francë konsideronin se vdekja e Kiderlenit, i njohur për mungesë simpatie ndaj Vjenës, e komplikonte situatën pasi tani nuk besonin se kishte ndonjë lider i cili nuk do të kishte frikë të mos pëlqej në Vjenë dhe për më tepër nuk ishin të sigurt se edhe për sa kohë Gjermania do t’ia dilte të përmbante bashkëpunëtorja e saj e Aleancës Trepalëshe. Franca, para së gjithash, ishte e interesuar që Gjermania të qëndronte paqësore dhe për aq kohë sa ajo qëndronte e tillë, edhe Franca nuk dëshironte gjë tjetër veç të vazhdojë me të një bashkëpunim, për të cilin ajo angazhohej. Francën po aq sa Rusinë i shqetësonte armatimi i Austro-Hungarisë.

Përkundrazi, me nxitjen e Sir Eduar Gry ambasadorët e fuqive evropiane iu përveshën punës me zell të madh. Me çfarë frymë e drejtonte sekretari i shtetit anglez trajtimin e çështjeve? Kumtimet e ambasadorit gjerman në Londër, princit Lichnowsky, më vonë na thonë. “Pak kohë pas mbërritje sime në Londër, në fund të vitit 1912, Sir Eduard Gry nxiti një shkëmbim pikëpamjesh që, pa i lidhur me ndonjë detyrim palët, kishte për qëllim të shmangej shpërthimi i luftës evropiane për shkak të luftës në Ballkan, sepse për fat të keq, në fillim të luftës, e kishim hedhur poshtë ftesën që na ishte bërë nga qeveria franceze, për t’u bashkuar në një deklaratë çinteresi.”

Në një telegram për ministrinë e jashtme në Berlin, ambasadori Lichnowsky njoftonte: “Edhe një kuriozitet: Grey më tregoi se shtetet ballkanike kanë pushtuar Londrën pa asnjë lloj paralajmërimi dhe se deri më tani, për pjesëmarrje ka pasur një marrëveshje vetëm me Bullgarinë.”⁶⁵

Qeveria e Berlinit u gjend kështu përpara një detyre të vështirë, të mbështeste Austro-Hungarinë, me të cilën ishte ngushtësisht e lidhur dhe bashkëpunonte plotësisht. Ministri i jashtëm austro-hungarez në shtator 1912-ës, në bisedën e përmendur tashmë mis Bethmann Woleg-ut dhe Bertholdit në Buhlaun, bëri të njohur edhe vullnetin e monarkisë për të mos pranuar asnjë fuqi të tretë në Adriatik. Konti austriak theksoi njëkohësisht se protektoratit austriak mbi katolikët në Shqipërinë e Veriut, e detyronte qeverinë e Vjenës që të mos dorëzohej myslimanëve pa u mbrojtur gjatë një rënie të sundimit osman.”⁶⁶ Perandoria Gjermane duhet të krijonte një mbështetje themelore për politikën e jashtme të Vjenës. Por, në kundërshtim me aleatët austro-hungarezë në Ballkan, Berlinit nuk kishte asnjë lloj interesi strategjik. Vëmendja e perandorisë gjermane u përqendrua më shumë te vetë Perandoria Osmane: Ekonomia gjermane ruajti marrëdhënie intensive tregtare me vendin aziatik.⁶⁷

Për shkak të firmave gjermane në Azinë e Vogël, qeveria e Perandorisë Gjermane nuk ishte e interesuar ta dobësonte Turqinë. Prandaj, Gjermania në

⁶⁴ Poincare, Raymond, Lufta e parë dhe e dytë ballkanike, si dhe Konferenca e Londrës (1912-1913), f. 445.

⁶⁵ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinete 1871-1914, Bd.32,

⁶⁶ Löhr, Hanns Christian, Die Gründung Albanians, f. 42.

⁶⁷ Thaden, Edward Carl, Russia and the Balkan alliance of 1912, Pennsylvania, 1965, f. 126.

fillim të krizës së Adriatikut, ashtu si Austro-Hungaria, ndërhyri që të ruante *Status quo*-në Ballkan, Menjëherë pas shpërthimit të Luftës së Ballkanit, qeveria e Berlinit gjithsesi duhet të konstatonte se territoret e dikurshme e Perandorisë Osmane kishin humbur Përpara sfondit të interesave parimore gjermane për Perandorinë Osmane, Kiderlen-Wächteri u përpoq tanimë të ndalonte që vendi të shkatërrohej plotësisht.

Sidoqoftë, sjellja e Vjenës ia vështirësoi punën diplomacisë gjermane që ta transmetonte këtë politikë. Bertholdi njoftoi zyrën e jashtme berlineze në mënyrën të pamjaftueshme për qëllimet e politikës së saj. Kështu ai e informoi palën gjermane vetëm për të dyja dekretet qarkore të gushtit në vitin 1912, në të cilat ai kishte propozuar një aksion të përbashkët të të gjitha fuqive në Perandoria Osmane. Kështu qeveria e Berlinit u përballë me një sulm diplomatik, i cili e gjeti atë krejt të papërgatitur, që e goditi dhe ra ndesh me politikën e saj.

Kërkesa e Bertholdit, për të mos lejuar në asnjë mënyrë një port serb në Adriatik, në Berlin gjeti një mirëkuptim.⁶⁸ Më 7 nëntor 1912, perandori gjerman Wilhelm II, në funksionin e tij si kryetar shteti, lëshoi një direktivë parimore për sekretarin e shtetit von Kiderlen-Wächterin. Në këtë dekret ai hidhte poshtë parimisht ndonjë luftë me Rusinë për shkak të porti serb në Adriatik. Ndaj Aleanca Trepalëshe nuk mund të futej në një luftë austriakuruse për shkak të një porti të tillë serb, bëri të ditur monarku. Me këtë, perandori gjerman kërkoi de facto që Gjermania të sillej në mënyrë asnjane në krizën e Ballkanit.

Kancelari i Rajhut dhe sekretari i shtetit shkuan te Perandori për t'u konsultuar me të për situatën. Bethmann Hollweg dhe Kiderlen-Wächter ishin po aq pak të gatshëm që të vareshin nga politika e Vjenës dhe për t'i dhënë Bertholdit një bazë për një politikë të "dorës së lirë." Gjermania nuk dëshironte të dukej të ishte sateliti i Austro-Hungarisë në Ballkan. Po ashtu, ishte e qartë se pa ndihmën e aleatit Austro-Hungaria nuk mund ta pengonte përparimin e Serbisë. Por, një disfatë e tillë diplomatike e Austro-Hungarisë, do të rrezikonte pozitën e Fuqive të Mëdha dhe si rrjedhojë do të dobësonte jo drejtpërsëdrejti edhe pozitën e Perandorisë Gjermanisë. Kancelari gjerman dhe sekretari i shtetit donin ta pengonin një luftë përmes ndërmjetësimit midis Austro-Hungarisë dhe Rusisë. Përpjekja gjermane për të shmangur një luftë austro-hungarez, u ndesh me të njëjtin interes prej anglezëve. Po ashtu, ministri i jashtëm anglez, Grey e njoftoi qeverinë gjermane në Berlin në lidhje me krizën që ekzistonte.

Nga ky interes i përbashkët i Gjermanisë dhe Anglisë u zhvillua një veprimtari e përbashkët ndërmjetësues. Berlioni e mbështeti në mënyrë të veçantë këtë ngjarje, meqenëse kancelari i Rajhut, Bethmann Hollweg, qysh prej fillimit të detyrës së tij synonte për një afrim gjermano-britanik.

⁶⁸ Hantsh, Berthold Bd.I, f. 338.

Bisedimet e para që kishte zhvilluar ministri anglez i tregtisë për këtë qëllim në vitin 1912, gjithsesi kishte dështuar. Kriza e Adriatikut tanimë i ofronte qeverisë së Rajhut gjerman një rast të ri të papritur që të afrohej me Anglinë. Ndërkohë, që u zhvillua ngadalë një bashkëpunim gjermano-anglez, u rrit mosbesimi gjerman ndaj politikës së Vjenës. Kiderlen-Wächter ishte vërtet i gatshëm që t'i siguronte Austro-Hungarisë ndihmën për të cilën perandoria që e detyruar ta jepte me marrëveshje në rastin e një sulmi nga Rusia. Gjermania donte ta ruante Austro-Hungarinë si Fuqi të Madhe, por ajo duhej të paralajmërohej për aksionet arbitrare. Kiderlen-Wächter në një artikull të publikuar në "Norddeutsche Allgemeine Zeitung" sinjalizoi qartë se Perandoria Gjermane nuk do ta përkrahte politikisht një veprim ushtarak kundër Serbisë. Në anën tjetër, zyrtarët anglezë në takim me ambasadorin gjerman në Londër Princin Lichnowsky, ia kishin tërhequr vëmendjen atij për faktin se Anglia nuk do të qëndronte asnjëherë në një luftë të përgjithshme në kontinent, por ishte e gatshme që ta ndihmonte Francën kundër një sulmi gjerman.⁶⁹ Ky duhej të ishte një sinjal gjerman për Perandorinë, që ajo të mos përzihej në asnjë aventurë diplomatike. Ishte e qartë se Anglia dhe Gjermania donin ta ruanin paqen në Evropë.⁷⁰

Në këtë mënyrë, politika gjermane i preu krahët ministrit të Jashtëm austro-hungarez, Bertholdit. Ai nuk mund të merrte më parasysh përkrahjen e Gjermanisë në kursin e tij kundër Serbisë. Qeveria e Vjenës kishte përshtypjen se Gjermania e kishte goditur pas shpinë në çështjet ballkanike, përkatësisht në çështjen e frenimit të ambicieve territoriale të Serbisë. Në fillim të dhjetorit 1912, ambasadori gjerman në Vjenë, Heinrich von Tschirschky i kërkoi Bertholdit që të informohet për hapat e mëtejshëm të politikës austro-hungareze në Ballkan. Por, Berthold nuk mund të jepte asnjë detaj për sjelljet e ardhshme të Austro-Hungarisë kundrejt Serbisë dhe Rusisë, për shkak të dilemave dhe paqëndrueshmërisë së politikës austro-hungareze. Nga njëra anë Berthold donte ta pengonte ndikimin e Serbisë në Ballkan për shkak të popujve sllavë, të cilët synonin pavarësinë në Monarkinë Habsburgase. Veç kësaj, ai dëshironte të pamundësonte depërtimin e Serbisë në Adriatik. Por, nga ana tjetër, ai e dinte se një luftë kundër Serbisë, ishte një rrezik i madh për paqen evropiane dhe për vetë monarkinë. Prandaj Austro-Hungaria vetëm sa i kishte mobilizuar trupat në Bosnjë dhe në Hercegovinë dhe nuk i kishte aktivizuar më tej. Ato vetëm duhet të pengonin një kryengritje të mundshme të sllavëve habsburgas të jugut, siç e formuloi i Jashtëm austro-hungarez në përgjigjen e tij për ambasadorin gjerman Tschirschky. Me përshtypjen se kriza po ashpërsohej perandori gjerman u bë aktiv, ai hoqi dorë nga qëndrimi fillestar asnjëherë kundrejt fateve të Austro-Hungarisë në Ballkan. Ai ishte i gatshëm

⁶⁹ GP 33, 12481 Lichnowsky drejtuar Bethmann Hollweg, 4.11. 1912, f. 451.

⁷⁰ Löhr, Hanns Christian, Die Gründung Albaniens, f. 46.

që ta zgjidhte problemin e pranishëm diplomatik edhe me mjete ushtarake.⁷¹ Ky reagim erdhi në dhjetor 1912 kur Anglia paralajmëroi që Gjermani të qëndronte asnjëherë në një luftë evropiane, gjë që te Wilhelm II shkaktoi ndjenjën e supozuar të një rrethimi ushtarak të perandorisë. Duke mos qenë në dijeni të fjalëve dashamirëse të Grey-it të 7 dhjetorit dhe të konsensusit të dallueshëm gjermano-anglez, perandori thirri për një diskutim më 8 dhjetor 1912-tës udhëheqësit ushtarakë gjermanë për të sqaruar masat strategjike dhe kërcënimin e pandehur ushtarak të Perandorisë.⁷² Por, meqë flota gjermane nuk ishte ende e gatshme për luftë, diskutimi përfundoi pa vendime konkrete ushtarake dhe tregoi se Gjermania nuk mund të parashtronte asnjë zgjidhje për krizën në Adriatik. Në anën tjetër, as kancelari dhe sekretari i tij i shtetit nuk dëshironin një kurs luftarak, ata mbështeteshin më shumë në diplomacinë e marrëveshjes së fuqive dhe u përpoqën të gjenin një zgjidhje kompromisi për krizën ndërmjet bashkëpunimit me Anglinë.⁷³ Ishte e qartë se ata nuk dëshironin një luftë me Rusinë shkaku i çështjes shqiptare, për të cilën Vjena kishte interesat e saj politike dhe ekonomike.

Çështja e Shkodrës

Sapo po rregullohej një çështje, në skenë doli një çështje tjetër. Edhe pse Fuqitë e Mëdha kishin vendosur që të krijonin një Shqipëri të pavarur, aleatët e Aleancës së Ballkanit përparuan në territorin shqiptar. Trupat serbe marshuan nga veriu deri në Lushnjë, ndërkohë që trupat greke pushtuan Epirin e rrethuan kështjellën e Janinës. Ndërsa Mali i Zi në shkurt 1913 i kërkoi Serbisë ndihmë për rrethimin e Shkodrës. Kështu në marsin e 1913-tës, trupat serbe mbështetën njësitet malazeze për ta rrethuar qytetin. Trupat e të dyja shteteve të Ballkanit ishin të organizuara dhe të armatosura keq, kështu që komandanti osman Hasan Riza Beu mund të mbrojtje me sukses për një kohë të gjatë. Por, kjo nuk kishte premisa të mira për çështjen e Shqipërisë.⁷⁴ Në tavolinën e ambasadorëve të Konferencës në Londër zuri vend çështja e Shkodrës. Austro-Hungaria u kundërvë me veto kategorike kërkesës së Malit të Zi për ta pushtuar qytetin shqiptar të Shkodrës.

Në këto rrethana, konferenca e Ambasadorëve u detyruar të shqyrtonte si çështje urgjente rastin e qytetit shqiptar të Shkodrës. Derisa ambasadori rus në Londër ishte pa udhëzime, në Shën Petersbug qarqet pansllave në oborrin e carit ishin për të ndihmuar Cetinjën dhe Beogradin. Ndërsa ministri i jashtëm Sazanov e pranoi Koncertin Evropian dhe veprimin e përbashkët të fuqive të tjera. Në fund të marsit fuqitë e Aleancës Trepalëshe kishin rënë dakord që t'u

⁷¹ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 -GP 33, 12205, Wilhelm II drejtuar Bethmann Hollweg, 1.10. 1913.

⁷² Löhr, Hanns Christian, Die Gründung Albaniens, f. 47.

⁷³ Löhr, Hanns Christian, Die Gründung Albaniens, f. 48.

⁷⁴ Löhr, Hanns Christian, Die Gründung Albaniens, f. 56-57.

propozonin fuqive të tjera se Austro-Hungaria dhe Italia duhet të merrnin një mandat për të zbatuar vendimet e Londrës, sipas vendimit të 22 marsit.

Sipas këtij plani, të dyja vendet duhet të bindnin Malin e Zi me mjete të përshtatshme që të njihte vendimin e Fuqive të Mëdha. Por, Grey hodhi poshtë propozimin. Prandaj, ambasadori gjerman Lichnowsky, pa udhëzimin përkatës të Berlinit, paraqiti me 26 paraqiti propozimin për një shfaqje të përbashkët të flotës së fuqive në bregdetin malazez nga princi Lichnowsky u bë pa urdhër nga Berlini.”⁷⁵ Ky është një njoftim që tregon se propozimi për një veprim të përbashkët ushtarak nga fuqitë e mëdha, në këtë rast një shfaqje flote në bregdetin malazez, nuk ishte miratuar ose urdhëruar nga autoritetet më të larta në Berlin.

Ambasadori gjerman po ashtu thekson se diskuton mundësinë e një kundërshtimi nga Mbreti Nikita ndaj vullnetit të fuqive të mëdha, duke përfshirë mundësinë e rinisjes së rrethimit, edhe pas një deklarate të përbashkët nga Sir E. Grey. Ai më tej thekson se përfaqësuesi i Rusisë në Londër, Grafi Benc-kendorff, i cili është i sëmurë, gjithashtu shprehu se do të ishte shumë e vështirë për publikun rus të kuptonte dhe pranojë nevojën e masave të detyrueshme ndaj Malit të Zi. Duke pasur parasysh këtë dhe situatën përshkruar më lartë, unë e konsideroj të pamundur të jap një mandat për austriakët dhe Italinë, por do të kthehem në çështjen e shfaqjes së flotës nëse efektet e propozimeve të para nuk janë të kënaqshme.

Në fund të telegramit Lichnowsky bënë me dije se seanca tjetër e radhës do të mbahej të premten pasdite, për të diskutuar rreth jugut të Shqipërisë.”⁷⁶

Ky telegram i Lichnowskyt fragment është një raport që shpreh shqetësimin e një diplomati gjerman për ndikimin që Rusia ka në negociatat ndërkom-bëtare në Londër, veçanërisht në lidhje me konferencën e ambasadorëve. Autori kritikon faktin që Rusia, si dhe përfaqësuesi i saj, kanë shumë pushtet në vendimmarrjen e asaj konference dhe janë ata që diktojnë shumicën e hapave. Nga ana tjetër, Lichnowskyt i duket se shtetet e tjera të mëdha (Austria, Italia dhe Gjermania) nuk janë duke u marrë parasysh dhe se Rusia po e merr drejtimin e gjithë procesit.”⁷⁷

Në këtë rrethanë, më 26 mars sekretari i shtetit për çështjet e jashtme i Gjermanisë, von Jagow, në udhëzimet e dërguara përfaqësuesit gjerman në Beograd, Freiherr von Griesinger, vinte në dukje se në mbledhjen e ambasadorëve të Londrës më 27 mars 1913, ishte miratuar menjëherë realizimi i protestës kolektive të vendosur më 22 mars. Në lidhje me largimin e forcave serbe

⁷⁵ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34 II, 23011 Flotow an an das Auswärtige Amt, 23.03. 1913; Nr. 13021, Der Botschafter in London Fürst von Lichnowsky an das Auswärtige Amt, London, den 26. März 1913.

⁷⁶ GP 34 II, Nr. 13021, Der Botschafter in London Fürst von Lichnowsky an das Auswärtige Amt, London, den 26. März 1913.

⁷⁷ GP 34 II, Nr. 13021, Der Botschafter in London Fürst von Lichnowsky an das Auswärtige Amt, London, den 26. März 1913. Berlin, den 27. März 1913.

dhe malazeze nga territori shqiptar, që duhej të realizohej sa më shpejt të jetë e mundur, duhet të merren masa për ruajtjen e rendit dhe sigurisë. Aty thuhej se Gjermania ishte dakord me formulimin e deklaratës përkatëse të përbashkët për këtë çështje.”⁷⁸

Ky fragment i telegramit tregon për një diskutim dhe miratim të veprimeve diplomatike që lidhen me një çështje të rendit dhe sigurisë në Shqipëri dhe është një pjesë e bisedimeve ndërkombëtare që përfshijnë disa shtete evropiane. Loja përmes prolongimit të vendimit ishte një lëvizje taktike për të fituar kohë derisa trupat serbe dhe malazeze të përparonin drejt Shkodrës. Një gjë e tillë duket qartë edhe nga raporti i Ambasadorit gjerman në Petersburg, Graj von Pourtalés, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, në të cilin tregon ka komunikuar me zotin Neratov përmes përmbajtjes së telegramit të mësipërm, pasi zoti Sasonov nuk ishte në gjendje ta priste.

Në Paris, njerëzit ishin të gatshëm të merrnin pjesë në një veprim të tillë kundër Malit të Zi vetëm nëse Rusia do të ishte e pranishme. Telegrami sekret i Isvolskit drejtuar Sasonov më 28 mars theksonte këtë. Megjithatë, Anglia dhe Franca pranuan të dërgonin një anije luftarake secila, një përkatësisht, në ujërat e Korfuzit, që do të qëndronin aty për përdorim të mundshëm kundër Malit të Zi.

Në raportin e ambasadorit gjerman thuhej se ndihmësministër rus nënvizoi se po shprehte mendimin e tij personal, por ai kishte premtuar se do t'i përcillte menjëherë komunikimet e tij Ministrit Sazanov.”⁷⁹

Përpjekjet për të ruajtur unitetin e Aleancës Trepalëshe morën goditje edhe nga Italia, e cila, sipas një letre private zë Ambasadorit von Flotow drejtuar sekretarit të shtetit von Jagow⁸⁰, më 23 mars, përshkruan deponimin e Marquis di San Giuliano në lidhje me Austrinë: “Në një bisedë shumë të besueshme, Marquis di San Giuliano i kishte thënë se ishte gati e pamundur të punohej me një politikë kaq të pasigurt, siç po vepronte Graf Berchtold. Kjo mund të shihet tani përsëri në rastin e Gjakovës, që u sakrifiku në momentin e duhur para rrezikut të tani-shpërthyer të rrethimit të Shkodrës, i cili mund të kishte çuar në zgjidhjen e gjithë konfliktit, ndërsa tani nuk ka asnjë avantazh të rëndësishëm nga kjo.”⁸¹

Dy ditë më pas, respektivisht më 25 mars 1913, Freiherr von Griesinger nga Beogradi informoi kancelarin gjerman në Berlin mbi zhvillimet e fundit

⁷⁸ GP 34 II, Nr. den 13022, Der Staatssekretär des Auswärtigen Amtes von Jagoë an Gesandten in Belgrad Freiherrn von Griesinger,

⁷⁹ GP 34 Bd.II, Nr. 13024, Schoen Der Botschafter in Petersburg Graj von Pourtalés an das Auswärtige Amt

⁸⁰ GP 34 Bd.II, Nr. 13026 Der Botschafter in Rom von Flotow an Nr. 55 Ich fand den Reichskanzler von Bethmann Hollweg Ausfertigung den Marquis di San Rom, den 23. März 1913

⁸¹ GP 34 Bd.II, Nr. 13026 Der Botschafter in Rom von Flotow an Nr. 55 Ich fand den Reichskanzler von Bethmann Hollweg Ausfertigung den Marquis di San Rom, den 23. März 1913.

në Shqipëri, ku iu dhanë instruksione për heqjen e rrethimit të Shkodrës, ndalimin e armiqësive dhe tërheqjen e menjëhershme nga territori shqiptar. Ai u interesua për qëndrimin e kolegut të tij rus, Zoti von Hartwig, në lidhje me këto instruksione, por ai e mohoi se kishte marrë të njëjtat. Nga raporti i tij mësojmë se në bisedën e tij me von Hartwig, përfaqësuesi rus e kishte kritikuar ashpër kërkesën për largimin e serbëve nga territori i Shqipërisë, duke e parë këtë si një hap që mund të çonte në luftë. Ambasadori rus Hartwig i kishte shprehur shqetësim se shqiptarët do të sulmonin dhe masakronin ortodoksët dhe se opinioni publik rus do të ishte i tronditur.⁸²

Në telegramin e ambasadori gjerman në Shën Petersburg (mars 1913), në të cilin ai informon mbi zhvillimet diplomatike rreth situatës në Ballkan, veçanërisht lidhur me kërkesat për të ndihmuar në zgjidhjen e krizës në Malin e Zi dhe çështjet e mundshme të mandatit për Austri e Itali, mësojmë se ndihmës ministri rus, Neratov, kishte shprehur dyshime rreth mundësisë që Rusia të miratojë këtë masë, duke sugjeruar se një veprim flotë të përbashkët mund të ishte opsioni më i mundshëm. Ai gjithashtu shpjegon se pasiguria e formuluar ende e masave kolektive të kërkuara në Londër mund të ndikojë në qëndrimin e Rusisë.

Në fund të telegramit, ka disa komente nga Perandori Wilhelm II, i cili shpreh kritika të ashpra ndaj politikës së vonuar të Rusisë, duke e konsideruar atë si një lojë të pasinqertë që dëmton mundësitë e ndërhyrjes gjermane dhe rrit kundërshtimin nga shtetet ballkanike.⁸³ Në fund, Griesinger theksoi se edhe pse von Hartwig mund të bashkëpunonte me hapin e përbashkët diplomatik, nuk mund të pritej një mbështetje e vërtetë nga ai, pasi ai mbante qëndrime të forta pansllaviste.

Austro-Hungaria e cila me 22 mars kishin arritur dakordësinë me Rusinë për vijën e kufirit të Shqipërisë veriore dhe lindore, ishte e pasigurt nëse Serbia dhe Mali i Zi do të pranonin këtë kufi sipas vendimeve të Fuqive të Mëdha⁸⁴ Prandaj, siç raportonte ambasadori gjerman nga Vjena Tschirschky në Ministrinë e Jashtme të Gjermanisë, Berchtold, po që kishte përshëndetur udhëzimet e dërguara në Londër, Paris dhe Shën Petersburg për çështjen e Shkodrës, ai shprehte dëshirën për një zgjidhje të shpejtë të kësaj çështje. Megjithatë, ai shpreh, po ashtu, dyshime për suksesin për shkak të qëndrimit të pasigurt të Rusisë.

⁸² GP, 34 Bd.II, Nr. den 13027 Der Gesandte in Belgrad Freiherr von Griesinger an Reichskanzler von Bethmann Hollweg Ausfertigung Nr. von der bei 51 Meine jüngsten Belgrad, den 25. März 1913.

⁸³ GP Bd. 34, Nr. 13024 Schoen Der Botschafter in Petersburg Graj von Pourtalés an das Auswärtige Amt Telegramm. Nr. 95 Entzifferung St. Antwort auf Telegramm Nr. 86}. Petersburg, den 26. März 1913.

⁸⁴ Me 4 mars, Jagow, i ngarkuari serb me punë në Berlin, kishte bërë të ditur se Beogradi nuk donte t'i përmbahej vendimeve të Fuqive të Mëdha, nëse kërkesat e saj territoriale në Shqipëri nuk do të ishin të pakënaqshme.

Në fund të këtij telegrami të ambasadorit gjerman mësojmë, po ashtu, Graf Berchtold, ministri i jashtëm i Austro-Hungarisë, tregon se ka në plan të dërgojë udhëzime në Stamboll (Kostandinopojë) për të siguruar që Esad Pasha, një figurë e njohur politike dhe ushtarake, të miratonte tërheqjen e civilëve (përjashtuar ushtarët) nga zonat e luftës. Kjo është pjesë e përpjekjeve për të pasur një kontroll më të mirë mbi situatën e sigurisë dhe për të siguruar një zgjidhje paqësore për problemet që kanë lindur si pasojë e luftës dhe tensioneve në rajon.⁸⁵

Meqë i ngarkuari serb me punë në Berlin kishte bërë të ditur se Serbia nuk do t'i përmbahej vendimeve të Fuqive të Mëdha, sekretari i shtetit i Gjermanisë i kishte kërkuar ambasadorit Lichnowsky në Londër që të shprehte shqetësimin për gjendjen e Shqipërisë, përkatësisht për mbështetjen ushtarake serbe të vazhdueshme dhe dërgesat e trupave në Shqipëri, veprime këto që përbënin edhe shkelje të rëndë të vendimeve të Fuqive të Mëdha, por gjithashtu shkaktonin edhe kushte të papranueshme për Shqipërinë. "Vendi, të cilit Fuqitë duan t'i sigurojnë një të ardhme shtetërore, përballet - në vend që të shijojë mbrojtjen e Evropës - me një situatë të vazhdueshme të luftës dhe është skena e shkatërrimeve dhe mizorive që kryhen ndaj pasurisë dhe jetës së popullsisë së tij. Kjo është një gjendje e tillë që është poshtëruese për Fuqitë që kanë marrë përsipër fatin e Shqipërisë. Jo vetëm nga një këndvështrim politik, por edhe nga ai humanitar, është e nevojshme që Fuqitë të ndalojnë veprimet e Serbisë dhe Malit të Zi," thuhej në udhëzimin e sekretarit të shtetit të Ministrisë së Jashtme në Berlin, z. Jagow drejtuar ambasadorit gjerman në Londër, Princit Lichnowsky.

Ai theksonte do të ishte gjithashtu e arsyeshme që Fuqitë në Konferencën e Londrës të miratonin një deklaratë të njëzëshme, duke vendosur se nuk duan të lejojnë vazhdimin e luftës të kotë në Shqipëri, dhe të shprehnin këtë vendim me forcë përmes përfaqësuesve të tyre në Cetinje dhe Beograd - ndoshta në formë të një demarshi kolektiv.⁸⁶ Por përderisa Kont Bertholdi mbronte parimin e caktimit të kufirit të Shqipërisë me Malin e Zi sipas parimit etnografik, sipas të cilit Shkodra është pjesë e Shqipërisë, perandori i Gjermanisë Wilehmi II komentonte se "mbajtja e trupave osmane në Shqipëri ishte e pamundur, dhe se parimi i përcaktimit të kufijve të Shqipërisë në baza etnografike do të ishte i vështirë për t'u realizuar. Për Wilhelmin një mundësi për Vjenën që nëpërmjet një oferte zhdëmtimesh, ta shtynte Malin e Zi të pranonte. Nën përshtypjen e Karl von Kagenekut, atasheut ushtarak gjerman në Vjenë, perandori gjerman kërkoi një ndërhyrje energjike: pasi tani ai po e

⁸⁵ GP Bd. 34, Nr. 13024 Schoen Der Botschafter in Petersburg Graj von Pourtalés an das Auswärtige Amt Telegramm. Nr. 95 Entzifferung St. Antëort auf Telegramm Nr. 86}. Petersburg, den 26. März 1913.

⁸⁶ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34 Bd.II, Nr. an 12972 Der Staatssekretär des Auswärtigen Amtes von Jagow den Botschafter in London Fürsten von Lichnowsky Eigenhändiges Konzept Nr. 429 Berlin, den 15. März 1913.

shihte humbjen e prestigjit të për Austro-Hungarinë dhe Italinë për të realizuar autonominë e Shqipërisë. Një aksion të tillë duhet të mbështeste Gjermania “*Counte que counte*”, “edhe me armë në dorë”.⁸⁷ Perandori gjerman ndërhyri me këtë për një zgjidhje ushtarake kundër Serbisë dhe Malit të Zi.

Sekretari i shtetit Jagow, e zbatoi urdhrin e perandorit. Më 7 prill 1913 ai njoftoi ambasadorin gjerman në Romë, von Flotowin, se Gjermania parapëlqente një aksion të përbashkët të Vjenës, e Romës për zgjidhjen e krizës aktuale. Por, Italia e kundërshtoi një aksion të përbashkët në Shqipëri. Atasheu ushtarak gjerman e përfundonte raportin e tij me konstatimin se në rrethanat e tanishme, shihte pak mundësi tjetër përveç asaj që serbët dhe malazezët do ta imponojnë vullnetin e tyre. Prandaj, ai rekomandonte se duhej gjetur ndonjë kompromis.⁸⁸

Perandori gjerman u tregua i luhatur mes të lëshuarit pe dhe marrjes së masave. Në këtë situatë më 8 prill ndërhyri kancelari perandorak. Në një telegram për Wilhelmin II, ai refuzoi që të paguante për t’i lëshuar pe Malit të Zi nëpërmjet zhdëmtimeve, sepse kjo nuk do t’i përgjigjej “autoritetit të Evropës dhe dinjitetit të pjesëmarrësve”. Veç kësaj një ndërprerje e projektit për të pavarësuar Shqipërinë, do të thoshte një “falimentim” i ndikimit ndërkombëtar të Austro-Hungarisë. Për dobësim të tillë të Austro-Hungarisë, kancelari e konsideroi atë si “detyrë shumë të rëndësishme” të politikës së Perandorisë Gjermane. Por, sipas pikëpamjes së tij, iniciativa për masa të mëtejshme, për t’ia imponuar vullnetin e fuqive evropiane Malit të Zi, duhej t’i lihej Anglisë dhe Antantës. Kështu do të shmangej një aksion të vetëm të Aleancës Trepalëshe.⁸⁹ Sipas kancelarit Bethmann Hollweg, në krizën ballkanike, Austro-Hungaria e pa si detyrë të parandalonte depërtimin e sllavëve deri në Adriatik. Baza për këtë politikë ishte marrëveshja me Italinë (Marrëveshja Goluchowski-Visconti),⁹⁰ sipas së cilës të dyja shtetet u angazhuan që, në rast të një ndryshimi të status quo-së, të lejonin vetëm krijimin e një Shqipërie autonome. Hollweg, pohonte se në radhë të parë, falë mbështetjes gjermane u arrit që kjo kërkesë të imponohej dhe që përpjekjet e Serbisë

⁸⁷ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13095, sich Jagow in Bericht des Militärattaches in Wien Majors Grafen von Kagenneck, den 5. April 1913.

⁸⁸ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13095, sich Jagow in Bericht des Militärattaches in Wien Majors Grafen von Kagenneck, den 5. April 1913

⁸⁹ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. an den im 13108 Der Reichskanzler von Bethmann Hollweg Rat Kaiserlichen Gefolge Gesandten von Treutler, Berlin, den 8. April 1913.

1913⁹⁰ bazuar në situatën e re të krijuar në Shqipëri për shkak të qëndrimit të Serbisë, që të bëhen sondazhe në Romë për të parë nëse Italia është e vendosur, në rast nevojë - pra, nëse mbledhja e ambasadorëve nuk do të ketë sukses - të veprojnë së bashku me Austrinë për të zbatuar Marrëveshjen Goluchowski-Visconti, me të cilën Gjermania do të ishte dakord. Shih; Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Der Rat im Kaiserlichen Gefolge Gesandter von Treutler, 2. Nr. 29 Seine Z. in Homburg v. d. H., an das Auswärtige Amt, Homburg v. d. H., den 9. April 1913

për të dalë në Adriatik të kufizoheshin vetëm në përdorimin e një porti tregtar.⁹¹ Përtej kësaj, kancelari gjerman dëshironte t'i përmbahej kursit të mirëkuptimit me Anglinë, të mos e rrezikonte këtë. Edhe Perandori e miratoi kursin e propozuar nga Hollwegu. Në fakt që nga fillimi i Konferencës së Londrës ambasadori princ Lichnowsky kishte marrë udhëzime nga Bethmann Hollweg të kultivonte një bashkëpunim me Anglinë, me qëllim që të largohej nga Antanta dhe të bashkëpunonte me Aleancën Trepalëshe. Në të njëjtën kohë, Berlini tregonte shqetësimet gjermane për dobësimin e pozitës së Austro-Hungarisë pas dështimeve të saj në Ballkan dhe thekson rëndësinë e mbështetjes gjermane për aleatin e saj. Krijimi i një Shqipërie të pavarur shihej si e vetmja arritje e Austro-Hungarisë pas dështimit të saj për të ruajtur ndikimin në Ballkan.⁹² Ishte e qartë se një dobësim i Austro-Hungarisë do të ndikonte negativisht edhe për Gjermaninë, ndaj mbështetja për aleatin ishte e domosdoshme. Çdo lëshim do të krijonte përshtypjen se Gjermania po e linte aleatin e saj në baltë, gjë që do të kishte pasoja për politikën e brendshme dhe të jashtme.

Duket se ky pozicion ishte refleksion i presionit të opinionit publik: Në Austri dhe pjesërisht në Gjermani kishte perceptime se Berlini nuk po e mbështeste mjaftueshëm Vjenën, ndaj kishte zëra politikë që kërkonin një qëndrim më të fortë në favor të Austro-Hungarisë.⁹³

Nga dokumentet diplomatike dalin qartë informacionet të cilat qartësojnë se Gjermania angazhohej për parandalimin e një konfrontimi të mundshëm ushtarak për shkak të çështjes së Shqipërisë dhe kufijve të saj përballë pretendimeve serbe. Aleati kryesor i Perandorisë Gjermane gjithmonë kishte dhënë sinjale të qarta se nuk kishte ndonjë interes të veçantë për Shqipërinë dhe përgjithësisht në Ballkan, mirëpo, politika e saj ballkanike u nxit nga Rusia dhe përpjekjet e saj kërcënuese ndaj Austro-Hungarisë. Në këtë atmosferë vazhdoi punën Konferenca e Londrës përgjatë vitit 1913, duke provuar të arrinte një kompromis mes interesave të Austro-Hungarisë dhe synimeve territoriale të Serbisë dhe vendeve të tjera ballkanike ndaj Shqipërisë, interesa që binin ndesh me Austro-Hungarisë, por që mbështeteshin nga Rusia dhe sidomos nga oborri i carit rus.

Në këtë situatë u bë e rëndësishme ideja e demonstrimit të përbashkët flotash, pasi vonesa e demonstrimit të forcës evropiane vinte në rrezik qytetin e Shkodrës. Lichnowsky u pyet përsëri nëse Gjermania do të merrte pjesë.

⁹¹ Shih; Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Der Rat im Kaiserlichen Gefolge Gesandter von Treutler, 2. Nr. 29 Seine Z. in Homburg v. d. H., an das Auswärtige Amt, Homburg v. d. H., den 9. April 1913.

⁹² Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13108, Der Reichskanzler von Bethmann Hollweg Rat Kaiserlichen Gefolge Gesandten von Treutler, den 8. April 1913.

⁹³ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13108, Der Reichskanzler von Bethmann Hollweg Rat Kaiserlichen Gefolge Gesandten von Treutler, den 8. April 1913.

Grey bëri një vërejtje të këndshme, siç raportoi Lichnowsky, duke thënë se Gjermania i jepte më shumë rëndësi deklaratës sesa pjesëmarrjes.

Ambasadori gjerman kërkoi, pra, që në seancën e ardhshme t'i jepej mundësia të shpallte pjesëmarrjen gjermane, "meqë mungesa jonë do të linte një përshtypje të pakëndshme." Nëse Mali i Zi nuk do të lëshonte pe pavarësisht demonstrimit të flotës, atëherë synohej të pengohej zbarkimi i mëtejshëm i trupave serbe dhe të pushtohej Tivari.⁹⁴ Ai raportonte Lichnowsky në Ministrinë e Jashtme në Berlin, me 31 mars 1913 në mbledhjen e Ambasadorëve ishte diskutuar fillimisht për atë se çfarë duhej bërë në lidhje me Malin e Zi, i cili po përgatitej të pushtonte Shkodrën me sulm ushtarak. Ambasadori gjerman Lichnowsky pohon se ai kishte shprehur me forcë mendimin se tani ishte momenti për të kaluar në një demonstrim flotash, pasi rreziku ishte afër dhe urgjent. Ky mendim u mbështet njëzëri, dhe Sir E. Grey informoi se kishte dërguar tashmë dy anije në Korfuz, dhe se ato, si dhe Fuqi të tjera, do të merrnin pjesë në demonstrim të përbashkët flotash kundër Malit të Zi.⁹⁵

Në mbledhjen e 28 marsit, Lichnowsky theksoi përsëri nevojën e masave të detyrueshme në rast të një përgjigjeje negative nga Mali i Zi. Grey mbështeti propozimin për një bllokadë të porteve dhe deklaroi se Admirali ishte urdhëruar të ndërmerre masat e nevojshme.⁹⁶ Nga ana gjermane, fillimisht ishte menduar (shihni Kap. CCLXX, Nr. 13 024, f. 560, shënim) që të mos merrnin pjesë aktivisht në demonstrim e përbashkët flotash, por ndryshuan qëndrim pas kërkesës të Anglisë.⁹⁷

Një diskutim i gjatë ishte zhvilluar në konferencën e Ambasadorëve mbi pyetjen se çfarë duhej bërë nëse Mali i Zi, pavarësisht demonstrim i përbashkët flotash, vazhdonte. Me 22 mars 1913, fuqitë e mëdha evropiane miratuan një rezolutë të cilën Mali i Zi dhe Serbia u ftuan të ndalonin rrethimin e Shkodrës dhe të ndalohehin të gjitha veprimet armiqësore në territoret që u ishin njohur Shqipërisë. Por, reagimi i Këshilli të Luftës të Malit të Zi ishte vendimi për të sulmuar dhe pushtuar Shkodrën. Duket sikur pikërisht lëshimi i politikës së jashtme austro-hungareze në çështjen e Gjakovës e kishte nxitur këtë mosbindje të Malit të Zi. Çdo tërheqje e monarkisë Austro-Hungareze tani shihej në Ballkan si një shenjë dobësie dhe inkurajonte politikën pansllaviste.

⁹⁴ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 – GP, II, Nr. 13058, Lichnowsky an das Auswärtige Amt Telegramm. Nr. 150 Bei der Entzifferung Mahmud Wangenheim N

⁹⁵ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13508, Der Botschafter in London Fürst von Lichnowsky an das Auswärtige Amt Telegramm. Nr. 150 Bei der Entzifferung Mahmud Wangenheim Nr. 13058 London, den 31. März 1913

⁹⁶ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13045 Der Botschafter in London Fürst von Lichnowsky an das Auswärtige Amt Telegramm. Nr. 146 Bei der Entzifferung London, den 28. März 1913.

⁹⁷ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13508, Der Botschafter in London Fürst von Lichnowsky an das Auswärtige Amt Telegramm. Nr. 150 Bei der Entzifferung Mahmud Wangenheim Nr. 13058 London, den 31. März 1913

Ishte e qartë se tani ishte në dorën e fuqive të mëdha të gjenin mënyra për të zbatuar vendimet e tyre të përbashkëta kundër Malit të Zi. Paaftësia e hapur për të vepruar në mënyrë të bashkërenduar e bëri të qartë për kabinetet e aleatëve ballkanikë se sa i madh ishte në të vërtetë hapësira e tyre e manovrimit përballë fuqive të mëdha.⁹⁸

Por, pikërisht një veprim unilateral i Austro-Hungarisë ishte ajo çfarë Fuqitë e Antantës dhe Italia e dëshironin më së paku. Prandaj, erdhi propozimi i një demonstrimi të përbashkët flotash.⁹⁹ Meqë Mali i Zi e bëri të qartë se nuk hiqet dorë nga sulmi mbi Shkodrën, Konferenca Ambasadorëve u morë me këtë çështje dhe sipas ambasadori gjerman princi Lichnowsky, ishte pikërisht ai që doli me propozimin e organizimin të një demonstrimi flotash të fuqive të mëdha, duke u nisur nga rreziku i afërt. Ky mendim i ambasadorët gjerman, i cili nuk dihet nëse ishte bërë me instruksionet e qeverisë në Belin, u miratua, dhe Sir E. Grey njoftoi dërgimin e dy anijeve në Korfuz, ndërsa fuqitë e tjera do të merrnin pjesë në demonstratë në Antivari. U pyeta nëse do të merrnim pjesë, dhe Sir E. Grey shprehu shqetësimin se po jepnim më shumë rëndësi demonstratës se pjesëmarrjes tonë. Po kërkoj që në mbledhjen e ardhshme të konfirmohet angazhimi ynë, pasi mungesa jonë do të kishte një ndikim të keq.

Austro-Hungaria kishte një divizion të flotës së saj të gatshëm për veprim në Kotor, i cili ndodhej në pritje në liman dhe ishte gatoi të zbatonte vendimin e marrë në Konferencën e Ambasadorëve në Londër për Shkodrën, qoftë në mënyrë të njëanshme. Në fakt përgjigja refuzuese që Mali i Zi i dha të drejtën morale Vjenës të ndërhynte, sepse tani ishte në pyetje prestigji i Monarkisë Danubiane. Për këtë arsye, Shef i Shtabit të Përgjithshëm dhe ministri i Mbrojtjes kërkuan një mobilizimin të menjëhershëm të korpuset 12,15, 16 të Armatës së Austro-Hungarisë, pasi tashmë rreth 60, 000 serbë dhe malazezë ishin mbledhur në kufijtë e monarkisë. në kufi të Monarkisë. Bllokada dhe kufijtë duhej të merrnin fund menjëherë.

Nën drejtimin e Sir Edward Grey ambasadorët e fuqive të mëdha evropiane miratuan tekstin e mëposhtëm:

“Konferenca është mendim se të gjitha fuqitë që kanë pranuar një demonstrim detar, duhet të procedojnë sa më shpejt të jetë e mundur përmes dërgimit të anijeve luftarake në Bari.” Sir Grey tha se ai ishte i gatshëm të dërgonte urdhra për anijet luftarake që ndodheshin në Korfuz për t’u nisur për në Bari sa herë që të njoftohej për dërgimin e udhëzimeve të ngjashme nga fuqitë e tjera.”¹⁰⁰

⁹⁸ Adalbert Gotfried, Krause, Das Problem der albanischen Unabhängigkeit in den Jahren 1908-1914, f. 237.

⁹⁹ GP. Bd. 34 Nr.13058, Der Botschafter in London Fürst von Lichnowsky an das Auswärtige Amt, London, den 31. März 1913.

¹⁰⁰ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinete 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13508, Der Botschafter in London Fürst von Lichnowsky an das Auswärtige Amt Telegramm. Nr. 150 Bei der Entzifferung Mahmud Ėangenheim Nr. 13058 London, den 31. März 1913

Por, pavarësisht kësaj ujdje, Sazanov nuk dëshironte ta mbështeste ushtarakisht një aksion të tillë. Rusia, që nuk kishte anije lufte në Detin Mesdhe nuk dëshironte të merrte pjesë në këtë demonstrim të përbashkët të fuqive evropiane. Ishte e qartë se e tërë taktika prolonguese konsistonte për t'i dhënë kohë Malit të Zi që ta pushtonte Shkodrën.¹⁰¹

Më 31 mars filloi beteja vendimtare për Shkodrën. Nga Shën Petersburgu u raportua se nuk kishte kundërshtime ndaj një aksioni të flotës, por Rusia nuk mund të merrte pjesë, pasi nuk kishte anije në Mesdhe. Në mbledhjen e 31 marsit vazhduan diskutimet mbi masat që duheshin ndërmarrë ndaj Malit të Zi. Lichnowsky e konsideronte tashmë momentin të përshtatshëm për veprimin e flotës. Siç raportonte ambasadori gjerman nga Shën Petersburg, gjatë një takimin me Sazanov ambasadorët pranishëm ishin informuar edhe për një telegram që ai sapo kishte marrë nga Vjena, sipas të cilit Mbreti Nikolla kishte urdhëruar një sulm ushtarak mbi Shkodrën me 31 mars.¹⁰² Edhe Franca ngurroi dhe refuzoi pjesëmarrjen e saj, për aq kohë sa aleati i saj Rusia refuzonte të merrte pjesë në një aksion të tillë.¹⁰³ Por, Gjermani e nxitoi Parisin të merrte pjesë. Berlini e konsideronte të domosdoshme një demonstrim të përbashkët flotash kundër Malit të Zi, pasi ky i fundit, duke mos respektuar vendimet e Konferencës Londrës (duke mbështetur dukshëm miqësinë me Rusinë), u shpreh me përbuzje ndaj fuqive të tjera evropiane.¹⁰⁴ Në fillim, gjermanët dëshironin të qëndronin jashtë demonstrimit të përbashkët të flotës, pasi e konsideronin më të drejtë që të ishte e realizuar nga katër fuqitë, dy nga secili grup, për të shmangur përshtypjen e një ndarje të Koncertit Evropian, dhe sepse Italia ishte më e interesuar për Adriatikun se sa Gjermania. Kjo gjithashtu i korrespondonte dëshirës së Rusisë.

Megjithatë, ambasadori Lichnowsky tërhoqi vëmendjen se duhej llogaritur edhe mundësia që Mali i Zi të qëndronte i vendosur dhe të vazhdonte rrethimin e Shkodrës ministri i jashtëm britanik nuk kishte kundërshtime ndaj një veprimi të përbashkët të flotës nga të gjitha fuqitë kundër Malit të Zi. Por ai u shpreh kundër dhënies së një mandati për veprim të pavarur të Austrisë, që do të përfshinte edhe Italinë.

¹⁰¹ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinete 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13055, Der Botschajter in Petersburg Graf von Pourtales an das Auswärtige Amt Telegramm. Nr. 103 Entzifferung St. Petersburg, den 31. März 1913.

¹⁰² Die Grosse Politik der Europäischen Kabinete 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13055, Der Botschajter in Petersburg Graf von Pourtales an das Auswärtige Amt. Nr. 103 Entzifferung St. Petersburg, den 31. März 1913.

¹⁰³ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinete 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13055, Der Botschajter in Petersburg Graf von Pourtales an das Auswärtige Amt. Nr. 103 Entzifferung St. Petersburg, den 31. März 1913.

¹⁰⁴ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinete 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13064 Der Staatssekretär des Auswärtigen Amtes von Jagow an Botschafter Telegramm. Nr. 98 Ëir in Paris Freiherrn Eigenhändiges Konzept Berlin, von den 2. Schoen April 1913

Për këtë arsye, Lichnowsky e riktheu sërish në vëmendje idenë e një veprimi të flotës, edhe pse nuk kishte marrë autorizim nga Berlioni. Kjo ide nuk hasi në kundërshtime, por asnjë vendim përfundimtar nuk u mor, pasi u vendos të pritej ndikimi i notës diplomatike.

Më 1 prill, ambasadori gjerman Lichnowsky përsëriti kërkesën e tij në një letër private drejtuar sekretarit të shtetit von Jagow për të miratuar këtë aksion të flotës. “Po shkakton shqetësim këtu fakti që, pasi kryesisht me nxitjen time, demonstrimi i flotës po ndodh tashmë, ne nuk po marrim pjesë. Sir E. Grey më bëri disa vërejtje të pakëndshme dhe mund të dyshojë për një lojë të dyfishtë. Këshilloj me ngulm që në bisedimet e nesërme të jem në gjendje të shpall pjesëmarrjen tonë, ...”¹⁰⁵

Pas kësaj, megjithatë, pasi edhe Franca nuk do të qëndronte jashtë, Gjermania e dërgoi menjëherë një anije të disponueshme për të marrë pjesë në demonstrimin e dërguar nga Athina në Bari. Pas kësaj dhe me presionin e Anglisë, edhe Franca pranoi të merrte pjesë në një demonstrim flotash.¹⁰⁶ Pas kësaj, anijet luftarake të pesë Fuqive Evropiane lundruan drejt Adriatikut. Ndërkaq, përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha në Londër vazhduan t’i kërkonin në rrugë diplomatike qeverisë malazeze dhe serbe që të tërhiqeshin nga Shkodra. Në fillim të shkurtit, siç raportonte i dërguari gjerman në Romë von Beneckendorff dhe von Hindenburg, në një telegram dërguar Kancelarit të Perandorisë, von Bethmann Hollweg, ministri i jashtëm italian në diskutimin në detaje lidhur me propozimin e fundit austriak për përcaktimin e kufijve të Shqipërisë kundrejt Malit të Zi dhe Serbisë me ministri i Jashtëm Marquis di San Giuliano tha se duhet të gjendet ndonjë mjet për të kënaqur Rusinë. Më pas ai ngriti çështjen që më kishte përmendur mundësinë që Malit të Zi të dëmshpërblehej financiarisht për “humbjen” e Shkodrës! Ndoshta ky lëshim mund të paraqitet si një sukses i Rusisë.¹⁰⁷ Berchtold më parë kishte qenë dakord me këtë ide, por tani nuk donte të dinte më për të. Në fillim të prillit, San Giuliano këtë propozim e futi sërish në bisedime. Ndoshta me këtë ide donte të ndihmonte, siç pretendonte ambasadori gjerman, Hans fon Flotow, dinastinë malazeze, e cila kishte lidhje farefisnore me mbretin italian.¹⁰⁸ Flotow po ashtu tërhiqte vërejtjen në Berlin se nëse Austria nuk merr

¹⁰⁵ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13059 Der Botschafter in London Fürst von Lichnowsky an das Auswärtige Amt Telegramm. 152 Privat. London, den 1. April 1913.

¹⁰⁶ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13064 Der Staatssekretär des Auswärtigen Amtes von Jagow an Botschafter Telegramm. Nr. 98 Eir in Paris Freiherrn Eigenhändiges Konzept Berlin, von den 2. Schoen April 1913.

¹⁰⁷ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, I, Nr. Nr. 12798, Der Geschäftsträger in Rom von Beneckendorff und von Hindenburg an den Reichskanzler von Bethmann Hollweg, Rom, den 5. Februar 1913.

¹⁰⁸ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13102, Der Botschafter in Rom von Flotow an das Auswärtige Amt Telegramm. Nr. 92 Entzifferung Rom, den 7. April 1913.

vendimin për të dhënë një kompensim financiar dhe përmirësim të parëndësishëm të kufirit për Mbretin Nikolla lidhur me Shkodrën, do të ketë rrezik për luftë. Të gjitha informacionet sugjerojnë se Mbretit Nikolla mund të pranojë të heqë dorë nga Shkodra për një kompensim të tillë të vogël, dhe nuk ka sens të rrezikohet shpërthimi i luftës për një ndryshim të tillë të kufirit. Ai i sugjeronte qeverisë perandorake gjermane që të të ushtronte presion të mëtejshëm në Vjenë dhe Shën Petersburg. Ndërkohë që bënte me dije se qeveria italiane kishte vepruar me energji në Paris dhe Londër për të ushtruar presion në Shën Petersburg, që Cetinja të bëhej më e gatshme për kompromis. Në të njëjtën kohë, San Giuliano, përmes të dërguarit gjerman në Romë, i bënte me dije Berlinit nuk mund të ketë asnjë qeveri në Itali që mund t'i bashkohet një lufte të tillë të provokuar nga Austro-Hungaria, e cila kishte rrezik se do të përballej me një agresion nga Rusia për ndjekjen e interesave të saj në Ballkan.¹⁰⁹ Sipas raporteve nga Roma, klima dukej shumë e dobët. Qeveria italiane insistonte që Mbreti Nikolla të parandalohet nga bllokada me një kompensim financiar, pasi lufta për Shkodrën në Itali ishte e papëlqyer nga publiku. Në këtë rrethanë, Sekretari i Shtetit të Ministrisë së Jashtme, von Jagow, në telegramin që i dërgonte Ambasadorit në Vjenë, von Tschirschky, e njoftonte se edhe Ambasadori perandorak në Londër i bënte me dije edhe Ministria e Jashtme britanike është e mendimit se Mali i Zi duhet të kompensohet, megjithatë, Anglia nuk mund të marrë pjesë në këtë proces. Lidhur me këtë Jagow tërhoqte vëmendjen se kjo situatë paraqiste rrezik, “nëse Mali i Zi nuk do të kompensohej, mund të rrëzohej dinastia dhe bashkimi i Malit të Zi me Serbinë do të bëhet shumë i vështirë për t'u parandaluar.”¹¹⁰ Përkundër kësaj situatë të tensionuar,

Përmes kanaleve konfidenciale Vjena zyrtare i kishte bërë të ditur palës gjermane se Graf Bertholdi kishte vendosur kundër dëmshpërblimit me para për Malin e Zi, sepse kjo do të ishte një dorëzim ndaj përpjekjes për shantazh të Mbretit Nikolla, për të cilin Austria e konsideron si një cenim të dinjitetit të saj, veçanërisht në këtë periudhë të rritjes së tensioneve. Berthold mendonte se një kompensim i tillë mund të inkurajonte edhe shtetet e tjera ballkanike të kërkonin më shumë. Po ashtu, në konferencën e datës 4, kishte folur kundër kësaj dhe është shprehur një mendim të ngjashëm dhe nga Sir E. Grey.¹¹¹ Në këtë mënyrë dështoi mundësia që nëpërmjet Fuqive të Antantës, të cilat ishin

¹⁰⁹ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13102, Der Botschafter in Rom von Flotow an das Auswärtige Amt Telegramm. Nr. 92 Entzifferung Rom, den 7. April 1913.

¹¹⁰ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13102, Der Botschafter in Rom von Flotow an das Auswärtige Amt Telegramm. Nr. 92 Entzifferung Rom, den 7. April 1913.

¹¹¹ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13094, Der Staatssekretär des Auswärtigen Amtes von Jagow an Botschafter in Rom von Flotow, Berlin, den 6. April 1913

kundër presionit më të madh të ushtruar ndaj Malit të Zi. Si rrugëdalje u afrua një aksion ushtarak i pavarur i Austro-Hungarisë kundër Serbisë dhe Malit të Zi për të realizuar vendimet e Konferencës së Londrës. Por, ishte e qartë se një vendim i tillë mund të kërcënonte paqen evropiane, ngaqë ndillte sërish rrezikun e një konflikti austro-rus.¹¹² Serbët dhe malazezët ishin të vendosur të realizojnë vullnetin e tyre. Nga rrethanat, që shiheshin pak mundësi për një zgjidhje tjetër, nëse nuk arrihet ndonjë kompromis në ndërkohë. Në anën tjetër, edhe në rrethet austriake në Vjenë ekzistonte qëndrimi se duke marrë parasysh që çështja e Ballkanit nga ana e Monarkisë ishte sjellë para forumit të Fuqive të Mëdha Evropiane dhe për këtë arsye ishte bërë një çështje e përbashkët evropiane, tani ekzistonte liria e veprimit të Monarkisë.¹¹³ Pavarësisht kësaj situate, Bertholdi, ashtu si edhe në krizën e Adriatikut, u gjend në dilemë. Ose duhej të rrezikonte të dështonte ose të ndërhynte me pasoja të paimagjinueshme. Natyrisht, në këtë rrethanë për Austro-Hungarinë i rëndësishëm mbetej qëndrimi i Gjermanisë, pasi pa ndihmën e saj ajo nuk kishte mundësi të ballafaqohej përballë shteteve sllave të Ballkanit, prapa të cilave qëndronte si gjithnjë Rusia. Ndërkohë Wilhelmi II i Gjermanisë refuzoi t'i bashkohej qëndrimi të Austro-Hungarisë, meqë kjo mund të çonte në një luftë botërore. Si mundësi të vetme për Vjenën, ai e shihte, që nëpërmjet zhdëmtimit ta shtynte Malin e Zi të pranonte tërheqjen. Ndërkaq, pohimet e ambasadorit rus në Beograd von Hartwig për mundësinë e bashkimit të Serbisë me Malin e Zi, Graf Berchtold i konsideronte si një simptomë të rëndësishme për planet e pansllavistëve rusë, pasi zoti von Hartwig duhet të dinte saktësisht pasojat që do të sjellë realizimi i këtij programi politik.”¹¹⁴

Në lidhje me përcaktimin e kufijve të Shqipërisë, Gjermania mbështeste dëshirat e aleatëve të saj, pasi ajo vetë nuk kishte interesa të veçanta atje. Megjithatë, Gjermania, siç deklaronte sekretari i shtetit i Ministrisë së Jashtme në Berlin Jagow, kishte vepruar për të siguruar respektimin dhe realizimin e këtyre dëshirave në mënyrë të shpejtë dhe të ndërmjetësuar. Në të njëjtën kohë, ai pohonte se është e nevojshme që të respektohen vendimet e marra, dhe ishte urgjente që të arrihej një marrëveshje paqeje ndërmjet Perandorisë

¹¹² Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13095 sich Jagow in Bericht des Militärattachés in Wien Majors Grafen von Kageneck Abschrift ee ré rd m er Nr. 26 Geheim Im k. Wien, den 5. April 1913.

¹¹³ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13095 sich Jagow in Bericht des Militärattachés in Wien Majors Grafen von Kageneck Abschrift ee ré rd m er Nr. 26 Geheim Im k. Wien, den 5. April 1913.

¹¹⁴ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13093 Der Staatssekretär des Auswärtigen Amtes von Jagow an Kaiser Wilhelm II., 2. Z. in Homburg v. d. H. Telegramm. Nr. 21 Entzifferung Berlin, den 6. April 1913

Osmane dhe shteteve ballkanike, pasi ishte e domosdoshme të shmanget një kolaps tjetër i shtetit osman dhe të ruhej ekzistenca e tij në Azi.¹¹⁵

Në një tjetër telegram diplomatik dërguar nga kancelari i Perandorisë Gjermane, von Bethmann Hollweg, dërguar përfaqësuesit austriakë në Vjenë, ai trajton një çështje të rëndësishme të marrëdhënieve ndërkombëtare gjatë periudhës së tensioneve në Ballkan, në vitin 1913. Kancelari u thotë atyre se çdo veprim i vetëm i Austro-Hungarisë do të kuptohej si largim nga përpjekjet ndërkombëtare për të zgjidhur situatën. Gjermania i kërkonte Austrisë të presë dhe të shohë se çfarë do të vendosnin shtetet e tjera, si Britania e Madhe, para se të merrte ndonjë hap të mëtejshëm.¹¹⁶ Një pjesë e rëndësishme e telegramit është kritika edhe ndaj politikës së Rusisë dhe Pansllavizmit. Gjermania e akuzonte Rusinë për të vonuar ndërhyrjen ndërkombëtare dhe për të shtuar rezistencën nga shtetet ballkanike, si Serbia dhe Mali i Zi. Ky vonim, sipas kancelarit, po e komplikon më tej situatën dhe po e rrezikon paqen në Ballkan.

Njëkohësisht kërkoheshin veprime të koordinuara: Gjermania insiston që të gjitha vendimet duhet të merren në kuadër të një koordinimi ndërkombëtar dhe që çdo veprim që dëmton këtë bashkëpunim mund të ketë pasoja të rënda. Kancelari gjerman sugjeron se nëse Anglia do të largohej nga ky koordinim, atëherë do të ishte përgjegjës për çdo pasojë negative që mund të ndodhte.¹¹⁷

Në fakt, në këtë situatë të komplikuar, Gjermania parapëlqente një aksion të përbashkët të Vjenës dhe Romës për të zgjidhur krizën e Shkodrës. Në të njëjtën kohë, perandori austro-hungarez Franz Joseph shprehte dëshirën për të mos u tërhequr nga bashkëpunimi me fuqitë e tjera të mëdha, duke u angazhuar për të ruajtur koherencën e politikave të përbashkëta ndërkombëtare. Njëkohësisht, ai e kishte mbështetur vendimin e trashëgimtarit të fronit për të mos e nxitur shumë ministrin e Jashtëm, Berchtold, në veprime të ngutshme që mund të çonin në eskalim të situatës.¹¹⁸ Por, nën këto rrethana kishte pak rrugëdalje, serbët dhe malazezët do ta zbatojnë vullnetin e tyre. Kjo mund të nënkuptojë se këto dy grupe ishin të vendosur të realizojnë qëllimet e tyre, pavarësisht pengesave ose kundërshtimeve të mundshme nga faktorë të jashtëm. Ky qëndrim paraqiste një rrezik për Shqipërinë autonome e cila tani po kërcënohej nga Serbia dhe Mali i Zi.

¹¹⁵ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. an den im 13108, Der Reichskanzler von Bethmann Hollweg Rat Kaiserlichen Gefolge Gesandten von Treutler, 2. Nr. 2 Zum Vortrag. Den mir durch Z. Euere in Homburg v. d. H.

¹¹⁶ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. v. 13109 Der Botschafter in Konstantinopel Freiherr von Eängenheim an das Auswärtige Amt Telegramm. Nr. 207 Entzifferung Konstantinopel, den 7. April 1913.

¹¹⁷ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. v. 13109 Der Botschafter in Konstantinopel Freiherr von Eängenheim an das Auswärtige Amt Telegramm. Nr. 207 Entzifferung Konstantinopel, den 7. April 1913.

¹¹⁸ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13095 sich Jagow in Bericht des Militärattachés in Wien Majors Grafen von Kageneck Abschrift ee ré rd m er Nr. 26 Geheim Im k. Eien, den 5. April 1913.

Në anën tjetër, edhe sipas marrëveshjes së vitit 1897 (marrëveshja Visconti-Goluchowsky), Italia dhe Austria kishin angazhuar veten për të mbrojtur autonominë e Shqipërisë në rast të ndryshimit të status quo-së në Ballkan. Ky ndryshim tani po dukej i mundshëm për shkak të veprimeve të Serbisë dhe Malit të Zi.

Për këtë arsye, Italia dhe Austria tani kishin detyrën për të mbrojtur autonominë e Shqipërisë, edhe nëse do të nevojitet përdorimi i forcës ushtarake, duke bërë një veprim të përbashkët kundër Serbisë. Kjo do të ishte një mundësi për të ruajtur një sukses të mundshëm nga politika dështake e Austriakëve në Ballkan dhe për të forcuar lidhjet mes Austro-Hungarisë dhe Italisë në kuadër të aleancës Trepalëshe.¹¹⁹

Në këto rrethana, perandori gjerman ndryshoi mendimin. Wilhelmi II ia përcolli pikëpamjen e tij Ministrisë së Jashtme që ta binte me ryshfet dorëheqjen e Malit të Zi nga Shkodra përmes zhdëmtimit. Në këtë situatë ndërhyri kancelari i Rajhiut i cili refuzoi që të paguante për t'i lëshuar pe Malit të Zi nëpërmjet zhdëmtimeve, sepse kjo nuk do t'i përgjigjej "autoritetit të Evropës dhe dinjitetit të Koncertit Evropian. Por, për të penguar një dobësim të Austro-Hungarisë, kancelari e konsideroi atë si "detyrë shumë të rëndësishme" të politikës së Perandorisë Gjermane.

Në përputhje me udhëzimet e Perandorit, qeveria gjermane mbetej besnike ndaj Austrisë-Hungarisë që nga fillimi i krizës ballkanike, duke u zotuar se duhej të parandalohet zgjerimin e ndikimit sllav deri në Adriatik. Baza për një politikë të tillë, thuhej në raport, ishte gjetur në marrëveshjen Goluchowski-Visconti, sipas së cilës të dy shtetet, Austro-Hungaria dhe Italia u zotuan se do të angazhoheshin se, në rast të ndryshimit të status quo-së, do të mbronin një Shqipëri autonome.

Por, edhe për Gjermaninë ishte e qartë për Austro-Hungarinë më e lehtë do të ishte më e lehtë që interesat e saj të mbroheshin në kuadër të "Koncertit" sesa përmes një politike të izoluar të veprimit veprim unilateral. Ndërkohë, aksioni i fuqive të mëdha kishte bërë ndikim vetëm te Serbia.¹²⁰ Më 9 prill, trupat serbe që kishin marrë pjesë në rrethimin e Shkodrës u kthyen në Selanik. Më 12 prill, kryeministri serb Pashiq i dha urdhër komandantit të trupave serbe të ndalonte çdo veprim kundër Shkodrës dhe të ndalonte çdo veprim të mëtejshëm në atë zonë.

¹¹⁹ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13095 sich Jagow in Bericht des Militärattaches in Ëien Majors Grafen von Kagenack Abschrift ee ré rd m er Nr. 26 Geheim Im k. Ëien, den 5. April 1913.

¹²⁰ Deri në atë moment Serbia kishte sjellë si ndihmë për malazezët gjashtë mijë serbë, dymbëdhjetë obusë, gjashtë artileri për rrethim, 40,000 kuaj dhe shumë municion kanë mbërritur nga Greqia. Ndërsa një anije ruse solli nga Rusia tetë topa, shumë municion dhe pallto ushtarake. Shih: Gp, Bd. II. Nr. , Der Gesandte in Cetinje von Eckardt an das Auswärtige Amt Telegramm. Nr 21 Die Entzifferung Cetinje, Regierung hat uns heute geantwortet*: 1. den 1. April 1913.

Ndërkaq, trupat malazeze vazhduan të vetme përpjekjet për pushtimin e qytetit. Koncerti Evropian dukej i pafuqishëm përballë këmbënguljes së Malit të Zi. Karakteristikë për qëllimet reale të diplomacisë ruse, franceze dhe italiane ishte një propozim i bërë me 17 prill, kur ambasadorët e këtyre fuqive sugjeruan në Konferencë marrjen në konsideratë të mitosjes së Mbretit Nikolla.¹²¹ Beckensdorf (ambasadori rus) Cambon (ambasadori francez) dhe Imperila (ambasadori italian), propozonin që Mali i Zi të merrte hua 1.200.000 funte, në këmbim të ndalimit të sulmit mbi Shkodrën.¹²² Në anën tjetër, ambasadori gjerman në Londër, Lichnowsky, i cili kishte lidhje të mira me qeveritarët britanikë, ishte përpjekur të ndikonte te kryeministri britanik

Lichnowsky e informonte Ministrinë e Jashtme të Gjermanisë për një takim me Kryeministrin britanik, Herbert Henry Asquith, më 25 prill 1913, në të cilin ai diskutoi veprimet e mundshme të përbashkëta të Austrisë, Italisë dhe Britanisë për të ndaluar pushtimin e Shkodrës nga Mali i Zi, por Asquith shprehu dyshime për përfshirjen e trupave britanike. Lichnowsky theksoi rëndësinë e një veprimi të koordinuar dhe shqetësimet për ndikimin e opinionit publik. Pas mbledhjes, diplomatët diskutuan mundësitë e ndërhyrjes.¹²³

Por, ndërsa Konferenca e Londrës nuk po arrinte një vendim final, Shkodra u dorëzua me 23 prill 1913. Komandanti shqiptar Esad Pashë Toptani, i cili kishte marrë komandën e trupave osmane në qytetin e rrethuar pas vrasjes enigmatike të komandantit osman të Shkodrës, Riza Pasha, hyri në negociatë me Malin e Zi dhe e dorëzoi pa luftë qytetin e Shkodrës dhe u tërhoq me armatim të gjitha trupave osmane e shqiptare.¹²⁴ Natyrisht dorëzimi i Shkodrës në duart e malazezëve e bëri situatën politike edhe më të vështirë dhe komplekse.

“Shkodra ka rënë dhe tani Evropa gjendet përballë çështjes më serioze që i është dashur të zgjidhë gjatë krizës ballkanike. Kjo çështje e Shkodër, e cila në vetvete është me rëndësi të vogël, përmban megjithatë çështje shumë të rënda për paqen botërore. Duhet bërë çdo përpjekje për të gjetur një zgjidhje të kënaqshme për të.”¹²⁵

Në Vjenë ishin të bindur se procedurat e ngadalta të Konferencës së Londrës nuk do të sillnin asnjë rezultat. Sidoqoftë, me 27 prill, ambasadori austro-hungarez, Graf Mensdorff, kërkoi në mënyrë ultimative ose pushtimin dhe bombardimin e porteve malazeze ose një ekspeditë ushtarake drejt Shkodrës.

¹²¹ Adalbert Gotfried, Krause, Das Problem der albanischen Unabhängigkeit in den Jahren 1908-1914, f. 239.

¹²² Adalbert Gotfried, Krause, Das Problem der albanischen Unabhängigkeit in den Jahren 1908-1914, f. 239.

¹²³ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13206 Der Botschafter in London Fürst von Lichnowsky an das Auswärtige Amt Telegramm. Nr. 189 Vor daß der Entzifferung London, den 25. April 1913.

¹²⁴ Immanuel, Der Balkankrieg 1912/13 Heft, 4, f. 55.7

¹²⁵ B.D. IX, ii, Nr. 891, Cartéight an Nicolson, 25 April 1913: Krit, Robert, Die Londoner Botschafter Konferenz 1912-1913, f. 118-119.

Çështja e Shkodrës po ndiqej me vëmendje, si nga ambasadori gjerman në Londër, princi Lichnowsky ashtu edhe nga qeveria perandorake në Belrin. Në këtë komunikatë, të lëshuar më dërguar më 27 prill, Sekretari i Shtetit për Punët e Jashtme të Gjermanisë, von Jagow, i përgjigjet ambasadorit gjerman në Londër, Princit të Lichnowsky, duke e vlerësuar pushtimin e Shkodrës nga Mali i Zi si një situatë të padurueshme. Ai thekson se Austria ka sakrifikuar interesat e saj për ruajtjen e unitetit të fuqive, dhe tani është momenti që fuqitë të veprojnë energjikisht për të mbajtur dinjitetin e tyre. Masat e ndërmarra deri tani janë të pamjaftueshme dhe vetëm veprimi i forcës mund ta detyrojë mbretin Nikolla të tërhiqet. Ai propozon që, nëse Mali i Zi nuk e liron Shkodrën brenda 48 orëve, të merren masa të detyrueshme dhe të organizohet një veprim i përbashkët i fuqive të angazhuara. Po ashtu, u diskutua se Shkodra duhet të lihet dhe të kalojë nën administratën e Fuqive të Mëdha, të cilat do të vendosin komandantët e forcave detarë ndërkombëtare. U vendos gjithashtu që qeveria malazeze të përgjigjej shpejt ndaj kërkesës për të larguar trupat e saj nga qyteti. Një pjesë e diskutimeve fokusohej në administrimin e Shkodrës, dhe për këtë qëllim, u propozua që komandohej një forcë detare, e cila do të koordinohet me konsujt në Shkodër për të mbajtur rendin dhe sigurinë.¹²⁶

Por, konti Berchtold refuzoi të paraqiste një notë proteste në Cetinjë.¹²⁷ Ai ishte kundër këtij hapi, sepse nota e planifikuar nuk kërcënonte me asnjë sanksion. Duke pasur parasysh përbuzjen e hapur të “vullnetit të Evropës nga ana e Malit të Zi”, ai kërkoi masa detyruese të të gjithë Fuqive për ta bindur Cetinjen. Ai njoftoi se kabineti austriak nuk do të merrte pjesë në një veprim kolektiv të propozuar nga Sir E. Grey në Cetinje. Për Austro-Hungarinë ai njoftoi se “nuk do ta linte me kaq këtë fyerje të rëndë.”¹²⁸ Njëkohësisht Austro-Hungaria, përmes ambasadorit të saj në Shën Petersburg e njoftoi edhe ministrin e jashtëm rus, Sasonov për hapat që po planifikonte të ndërmarritë, edhe pse këshilla ruse ishte të pritej efekti i një veprimi kolektiv diplomatik.¹²⁹

Më 25 prill, Konferenca e Ambasadorëve u mbledh sërish, por Fuqitë e Mëdha vazhdonin të mos bashkoheshin në një linjë të palëkundur: Antanta ishte stërkite ndaj çdo lloj masash detyruese. As nga vendet e Aleancës Trepalëshe nuk kishte ndonjë qëndrim të unifikuar.

Ambasadori gjerman në Londër, Princ Lichnowsky, informonte Ministrinë e Jashtme të Gjermanisë për mbledhjen e ambasadorëve të

¹²⁶ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13207 Der Staatssekretär des Auswärtigen Amtes von Jagow an den Botschafter in London Fürsten von Lichnowsky Telegramm. Nr. 263 Konzept Berlin, den 26. April 1913.

¹²⁷

¹²⁸ HHStA XII 427, LXV/II fl.419, Qarkore zyrtare e Berchtold, 23.4. 1913.

¹²⁹ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13269 Der Botschafter in Petersburg Graf von Pourtalès an das Auswärtige Amt Telegramm. Nr. 145 Entzifferung St. Petersburg, den 4. Mai 1913.

udhëhequr nga Kryeministri Britanik Asquith,¹³⁰ ku ishte diskutuar situata në Shkodër pas marrjes së qytetit nga Mali i Zi. Në këtë takim ishte arritur një konsensus për të kërkuar që Shkodra të kalonte në duar të Fuqive të Mëdha dhe për të evituar çdo masë drastike. Ishte diskutuar gjithashtu mundësia e veprimeve të përbashkëta për paqe dhe dërgimi i një mesazhi kolektiv për të ndaluar veprimet ushtarake. Perandorit Wilhelm II theksonte shqetësimet për veprimet e ngadalshme të fuqive dhe reagimin ndaj presionit nga ana e Malit të Zi. Nga ana e tij, perandorit Wilhelm II theksojnë shqetësimet për vonesat në veprimet e fuqive dhe presionin e Malit të Zi.

Ndonjë qëndrim i madh mbështetës për Austro-Hungarinë lidhur me Shkodrën nuk po vinte as nga aleatja tjetër, Italia e cila edhe më tej insistonte se është thelbësore që të mbahej një veprim i koordinuar mes fuqive evropiane dhe të shmangen kërkesa të ashpra në fillim, duke u rritur gradualisht presionet ndaj Malit të Zi. San Giolitti, sipas ambasadorit gjerman në Romë, Flotow e një veprim të njëanshëm të Austro-Hungarisë e shihte, me ose pa mandat, si një rrezik të madh, jo vetëm për shkak të mundësisë për luftë me Rusinë, por edhe për shkak të ndikimit të mundshëm negativ në marrëdhëniet italo-austriake. Ai sugjeronte që Austro-Hungaria të veprojë me durim dhe të procedojë ngadalë. Sipas Giolitti-t, një veprim i përbashkët mes Italisë dhe Austrisë pa përfshirjen e fuqive të tjera nuk ishte i mundur për momentin, por mund të arrihej një angazhim nominal i Anglisë për të evituar rrezikun ndaj trupave britanike.

Tani për të gjithë ishte e qartë se Mbreti Nikolla i Malit të Zi do t'i duhej presion i ndjeshëm nga fuqitë e mëdha evropiane për të qenë i detyruar të tërhiqej dhe për ta justifikuar një veprim të tillë para publikut malazias.

Sidomos, Shën Petersburgu refuzoi kërkesat e forta të Austro-Hungarisë dhe nuk ishte i gatshëm t'i bënte presion malazezëve që të largoheshin nga Shkodra. Rusia deklaroi se aktualisht misioni i saj është përmbushur, por ajo do ta quante se misioni i saj do të rifillonte, në rast se do të cenohej pavarësia e shteteve ballkanike.¹³¹ Sipas ministrit të Jashtëm rus Sazanov, zhvillimi i ngjarjeve politike të mëtejshme varej nga dy faktorë, të cilët nuk ishte lehtë t'i përcaktoje që më parë: së pari nga pëlqimi i mbretit Nikolla që të bindej nga këmbëngulja e fuqive të mëdha dhe të hiqte dorë nga pretendimet e tij për Shkodrën, duke i premtuar në shkëmbim një shpërblim tjetër, së dyti,

¹³⁰ Mungesës së Sir Edward Grey në këtë dhe një mbledhje i referohen se mund të tregonte një ndarje të brendshme në qeverinë britanike, ku kishte shqetësime se Grey mund të shkonte shumë larg në angazhimin e tij. Në kujtimet e tij, Grey nuk përmend mungesën nga mbledhja, por thekson ngurtësinë e qëndrimit të Malit të Zi ndaj këshillave britanike, duke shprehur hidhërimin se këshillat e fuqive, edhe kur ishin të mbështetura nga argumente të pakundërshtueshme, nuk kishin asnjë efekt.

¹³¹ Poincare, Rymond, Lufta e parë dhe e dytë Ballkanike si dhe konferenca e Londrës, f.385-386.

nga ato mënyra të presioni me të cilat do të ndalej qeveria austro-hungareze, në rast të refuzimit të saj dhe ta detyronte atë që të bindej.

Edhe pse qeveria ruse qëndronte fort në fakti, se ajo nuk do të lejonte veten që të hyjë në luftë për shkak të një problemi ballkanik të dorës së dytë, për arsye tepër të kuptueshme, për atë ishte jashtëzakonisht e rëndësishme që të pengonte ndëshkimin individual të Malit të Zi nga ana e Austro-Hungarisë, duke pasur parasysh forcën e madhe të Monarkisë së Habsburgëve, në krahasim me ta të mbretërisë së vogël ballkanike. Prandaj, gjithë përprjekjet e Sazanovit ishin drejtuar ta nxiste Francën dhe Anglinë, duke pasur parasysh pamundësinë për Rusinë që të merrte pjesë në masat shtrënguese kundër Malit të Zi, të dërgonin anijet e tyre në Tivar dhe, në qoftë se pastaj do të ishte e nevojshme zbarkimin e desantëve, t'i jepte kësaj karakter ndërkombëtar, më pak fyes për sedrën e Malit të Zi.¹³² Në këtë mënyrë, Rusia shpresonte të shmangej gjithashtu rreziku i urdhrit të pakontrolluar të Austro-Hungarisë për fatin e shtetit të vogël sllav, të lidhur me Rusinë me miqësi shekullore dhe që gëzonte mbrojtjen e veçantë të carëve rusë. Rusia nuk pajtohej në këtë proces, pikëpamjet e jo vetëm të gjithë ambasadorëve të Konferencës së Londrës, por dhe të përfaqësuesve të shteteve të Antantës të cilët nuk dëshironin të merrnin pjesë në këtë ndërmarrje kolektive evropiane të demonstrimit detar në ujërat e Tivartit, që i kërkonte Evropa përballë kërcënimeve për ndërhyrje individuale të qeverisë së Vjenës.¹³³

Në këtë komunikim, Ambasadori në Londër, Princ Lichnowsky, informon Ministrinë e Jashtme të Gjermanisë për mbledhjen e djeshme të ambasadorëve që u udhëhoq nga Mr. Asquith, dhe që është zhvilluar nën ndikimin e lajmeve për marrjen e Shkodrës nga Mali i Zi. U arrit një konsensus për të shpallur qëndrimin e fuqive në Cetinje, duke kërkuar që Shkodra të lihet dhe të kalojë në duar të Fuqive të Mëdha. U shqyrtua mundësia e marrjes së veprimeve të mëtejshme, por u vendos që të shtyhej çdo masë drastike dhe të mos shqyrtohet mundësia e një ndihme ushtarake të drejtpërdrejtë. U diskutua edhe rreth mundësisë për të informuar fuqitë për të nisur veprime të përbashkëta për paqe dhe të dërgohet një mesazh kolektiv për të ndaluar veprimet ushtarake dhe për të zhvilluar bisedime paqeje.

Përfundimisht, u arrit në një marrëveshje për të ndihmuar në koordinimin e një njoftimi të përbashkët për të ndaluar veprimet luftarake dhe për të siguruar një konferencë paqeje. Në fund, disa komente të perandorit Wilhelm II theksojnë shqetësimet për veprimet e ngadalshme të fuqive dhe reagimin ndaj presionit nga ana e Malit të Zi. Por, edhe trashëgimtari I fronit austriak, Franc Ferdinand e pranoi se për aq kohë sa Koncerti Evropian bashkëvepronte “formalisht”, një aksion i pavarur i Austro-Hungarisë ishte i “pamundur.

¹³² Sazanov, Sergej Dmitrievič, Kujtime, f. 119.

¹³³ Sazanov, Sergej Dmitrievič, Kujtime, f. 120.

Sidoqoftë për Vjenën vështirë të ekzistonte shansi që të ndërmerreshin disa masa në marrëveshje me fuqitë të tjera. NË fakt ishte vetëm Gjermania që provonte ta ndihmonte Vjenën pa rrezikuar pozicionin e saj ndërkombëtar.

Kjo duket qarë edhe nga angazhimi intensiv i qeverisë dhe diplomacisë gjermane. Princi von Lichnowsky, Ambasadori gjerman në Londër, raporton me 26 prill se një bisedë me Sir A. Nicolson, i ka theksuar situatën e rëndë dhe nevojën urgjente për të parandaluar një kthesë të papëlqyer. Ai sugjeron që Anglia të marrë drejtimin për të shmangur një përshkallëzim, duke u përpjekur të bindë malazezët të heqin dorë nga Shkodra. Lichnowsky tregon se Sir Nicolson është dakord me këtë qasje, por thotë se Anglia nuk mund të angazhohet në një aksion ushtarak të përbashkët të fuqive, as të mbështesë një mandat për Austro-Hungarinë ose Austro-Hungarinë dhe Italinë, pasi Rusia nuk do të mund të pranojë këtë.¹³⁴

Nicolson është i gatshëm të flasë me Popoviçit, përfaqësuesin malazez, për të propozuar një marrëveshje që do të përfshijë heqjen dorë nga Shkodra në këmbim të përpjekjeve të fuqive për të mbrojtur interesat e tjera të Malit të Zi. Në këtë kontekst, Lichnowsky sugjeron se një ndryshim i vogël i kufirit të veriut të Shqipërisë mund të diskutohet, megjithatë, pasiguria është e madhe për realizimin e kësaj, pasi Popoviç ka shprehur preferencën për t'u aneksuar nga Austro-Hungaria, duke sugjeruar që kjo do t'u sigurojë kushte më të mira për pjesëtarët e popullatës malazeze.¹³⁵

Ndërkohë sekretari i shtetit të punëve të jashtme, von Jagow, njofton se një veprim i përbashkët i Italisë me Austro-Hungarinë pa përfshirjen e fuqive të tjera nuk është arritshëm në këtë moment, përveç nëse Anglia përfshihet në mënyrë nominale. Ky angazhim do të sigurojë që trupat britanike të mos rrezikohen. Sipas burimeve diplomatike gjermane, Mbreti Nikolla ishte në pritje të një presion të dukshëm nga fuqitë evropiane për të treguar fleksibilitet dhe për t'u justifikuar për veprimet që do të merrte.¹³⁶ Mirëpo, Jagow në fakt ishte pro linjës energjike të Austro-Hungarisë dhe kishte mbrojtur një aksion austriak të posaçëm, me kushtin që, "Koncerti i Fuqive" duhej të tregohej "impotent".¹³⁷ Veç kësaj, me 25 prill ai i ishte zotuar fshehurazi ambasadorit

¹³⁴ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13211 Flotow Der Botschafter in London Fürst von Lichnowsky an das Auswärtige Amt Telegramm. Nr. 191 Ich Entzifferung London, den 26. April 1913.

¹³⁵ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13211 Flotow Der Botschafter in London Fürst von Lichnowsky an das Auswärtige Amt Telegramm. Nr. 191 Ich Entzifferung London, den 26. April 1913.

¹³⁶ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13212 bedenklich erschiene, Lichnowsky Der Staatssekretär des Auswärtigen Amtes von Jagow an den Botschafter in London Fürsten von Lichnowsky Telegramm. Nr. 266 Im Der Konzept von der Hand des Vortragenden Rats von Rosenberg Berlin, den 27. April 1913 13.

¹³⁷ Löhr, Hanss Christian, Die Gründung Albaniens, f. 82

austriak se në rastin e një aksioni të veçantë të Vjenës, ky do të lejohej nga “të gjithë faktorët vendimtarë të Gjermanisë.”¹³⁸

Ndaj ambasadori gjerman në Vjenë, më 26 prill 1913 e informoi sekretarin e shtetit Jagowin, se perandori austriak Franc Josephi I zgjidhjen e vetme të çështjes së Shkodrës e shihte përmes një politike “energjiqe” të Vjenës, nëse fuqitë e tjera do ta shtynin më tej zbatimin e vendimeve të tyre. Edhe përpara se Jagowi të mësonte se Monarkia Habsburge do të përmbushte “dëshirën evropiane” ai kishte vendosur vetë për një linjë energjiqe vetë më parë e kishte njoftuar te kabinetet tjera idenë e një aksioni austro-hungarez të posaçëm.

Kur sekretari gjerman i shtetit e mori tashmë letrën nga ambasadori gjerman në Vjenë, Heinrich Leonhard von Tschirschky, ai kërkoi, në përputhje me idetë austro-hungareze, një ultimatum të Fuqive të Mëdha për Malin e Zi. Njëkohësisht Jagowi theksoi se Gjermania ishte e vendosur që të mos e “pengonte” Austro-Hungarinë për një veprim të pavarur. Megjithatë ai vazhdoi të shpresonte se Koncerti do të arrinte në një vendimi, “të cilin e kërkonte besnikëria dhe dinjiteti.” Si rrjedhojë, Drejtori i zyrës së punëve të jashtme ndoqi një linjë politike, të cilën e kishte përfaqësuar në fillim të prill edhe perandori.

Edhe vetë ministri i luftës i Austro-Hungarisë, Alexander Freiherr von Krobatin, ishte i mendimit se rezistenca e Malit të Zi nuk mund të thyhej vetëm me rrugën e ndjekur deri tani, por se ishte e nevojshëm edhe një veprim energjik nga ana e Austro-Hungarisë për të rivendosur imazhin e monarkisë si një fuqi të madhe. Edhe Ministri i Mbrojtjes kishte shprehur pajtueshmëri të plotë me këto mendime dhe kishte theksuar se, për sa kohë që do të përdoren mjete paqësore, ai nuk do ta ndihmojë atë, por nëse duhet të përdoren masa më të ashpra, ai mund të mbështetet plotësisht nga Shtabi i Përgjithshëm dhe ushtria. Qarqet ushtarake austriake kishin bërë me dije se ishin gati t’i ofronin Italisë jugun e Shqipërisë dhe Vlorën, me kushtin që Italia të pranojë që në brigjet lindore të Adriatikut, nga juglindja e Kotorrit, të mos krijohet një bazë e fortifikuar për flotën. Ky propozim për t’i dorëzuar Vlorën për Italinë ishte diskutuar vetëm në rrethe të ngushta ushtarake.¹³⁹

Njëkohësisht Jagow theksoi se Gjermania ishte e vendosur që të mos e “pengonte” Austro-Hungarinë për një veprim të pavarur. Megjithatë ai vazhdoi të shpresonte se Koncerti Evropian do të arrinte në një vendim, por ai ishte i bindur se veprimet e ndërmarra nga diplomatët deri tani, si bllokada më e ashpër dhe premtimet për lëshime të tjera, ishin treguar të pamjaftueshme për të ndikuar në Malin e Zi. Jagoë e këshillonte ambasadorin princin von Lichnowsky se vetëm një përdorim i forcës do të detyronte Mbretin Nikolla të tërhiqej nga Shkodra, dhe sa më shpejt të ndërmerret veprimi, aq më e lehtë

¹³⁸ HHStA 427, XLV/II fl. 539 Szögyeny drejtuar Berthold, 25.4. 1913

¹³⁹ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Bericht des Militär-attachés in Wien Majors Grafen von Kagenack Abschrift Nr. 36 Wien, den 26. April 1913.

do të jetë detyra dhe më pak do të jenë mundësitë për komplikime të mëtejshme.”¹⁴⁰ Si rrjedhojë, ai e ndoqi një linjë politike, të cilën e kishte përfaqësuar në fillim të prillit edhe perandori. Pavarësisht pohimeve të Berchtoldit se Shën Petersburgu do e toleronte një aksion të vetëm të Vjenës kundër Malit të Zi, ambasadori gjerman atje, Fridrich fon Pourtales pohonte të kundërtën, se ministri i Jashtëm Sazanov e kundërshton përdorimin e masave të dhunshme dhe çdo veprim të pavarur të Austrisë, duke propozuar një bojkot financiar si mjetin më të sigurt. Ai vlerëson se një veprim i Austrisë do të dëmtonte imazhin e Rusisë dhe do të forconte pozitat e Mbretit Nikita.¹⁴¹

Pavarësisht, sekretari i shtetit Jagow mori përsipër rrezikun e mbështetjes së Austro-Hungarisë Në këtë linjë po thuajse u shpreh edhe perandori gjerman Wilhelmi II, I ciko i në një shënim mbi telegramin të Jagowit kishte vendosur këtë fragment, i cili përmban shqetësimin e Perandorit Wilhelm II për pasivitetin e Sir Edward Grey, ministrit të Jashtëm britanik, në zgjidhjen e situatës ndërkombëtare. Perandori gjerman kritikon veprimet e vonuara të Grey dhe thekson se, pa ndërhyrje energjike, fuqitë e mëdha do të humbasin ndikimin e tyre. Wilhelmi I gjithashtu thekson se Austria, si krijuese e Shqipërisë, nuk mund të lejojë që Shkodra të merret pa reagim, pasi do të ndikonte negativisht në politikën e saj.¹⁴²

ME këtë qëndrim tregon dëshirën e Perandorit Wilhelm II për të ruajtur një “Koncert Evropian” dhe për të shmangur veprimet njëanëshe të Austrisë-Hungarisë. Ai dëshiron një bashkëpunim të koordinuar midis fuqive evropiane për të parandaluar që një shtet të veprojë në mënyrë të pavarur, duke rrezikuar kështu stabilitetin dhe ekuilibrin ndërkombëtar.

Grey reagoi menjëherë ndaj qëndrimit gjerman: ministri i Jashtëm anglez, siç raporton Lichnowsky, thoshte se Britania është e angazhuar për të mbajtur pozitat e saj dhe, nëse nuk do të arrihej një marrëveshje, Britania nuk do të kundërshtonte një veprim të njëanshëm nga Austria për realizimin e vendimeve mbi Shkodrën. Grey preferonte deri në fund të shfrytëzonte të gjitha mjetet diplomatike për të penguar një aksion ushtarak të vetëm të Vjenës. Në këtë linjë, ai shprehet i shqetësuar se Austria mund të përballlet me një sfidë të madhe për të detyruar Mbretin Nikolla që të tërhiqet, duke nënvizuar se një operacion ushtarak mund të kërkojë rreth 60,000 trupa dhe

¹⁴⁰ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13207 Der Staatssekretär des Auswärtigen Amtes von Jagow an den Botschafter in London Fürsten von Lichnowsky Telegramm. Nr. 263 Konzept Berlin, den 26. April 1913.

¹⁴¹ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13229 Der Botschafter in Petersburg Graf von Pourtales das ann Nr, Auswärtige Amt Telegramm. 'Entzifferung 140 Antwort auf Telegramm Nr. 128**', Herr St. Petersburg, den 28. April 1913.

¹⁴² Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. Schoen 13195 Der Staatssekretär des Auswärtigen Amtes von Jagoë an Kaiser Wilhelm II., z. Z. in Metz Telegramm. Nr. 61 Entzifferung Berlin, den 24. April 1913.

tre muaj kohë.¹⁴³ Ai shprehte, po ashtu, dyshime për idenë e bombardimit të një qyteti bregdetar malazez dhe më pas një ekspeditë të brendshme, duke e konsideruar atë një masë të pasigurt.¹⁴⁴

Në mbledhjen e ambasadorëve të 28 prillit, ambasadori austro-hungarez ambasadori i Austrisë, Mensdorff, u përpoq për një veprim të përbashkët të fuqive evropiane. Ai propozoi që, nëse mbreti i Malit të Zi, Nikita, vazhdon të sillet në mënyrë të vonuar ose refuzon të zbatojë kërkesat e fuqive të mëdha, atëherë mund të përdoren masa si bombardimi ose pushtimi i disa qyteteve bregdetare malazeze, përfshirë edhe Shkodrën.¹⁴⁵ Por, qëndrimi i Fuqive të Mëdha ishte për evitimin e një përplasje të armatosur: Përfaqësuesit e Francës dhe Italisë shprehin shqetësimin për një ndërhyrje të drejtpërdrejtë, por janë dakord për mundësinë e një deklarate për të bërë thirrje ndaj Mbretit Nikolla që të pranojë kërkesat e fuqive të mëdha, duke e lënë mundësinë për një zgjidhje paqësore, duke shmangur një përplasje të mëtejshme.¹⁴⁶

Sipas raportit të ambasadorin gjerman në Londër, Lichnowsky, dërguar në Ministrinë e Jashtme të Gjermanisë në Belin, përfundimisht, ndërhyrja ushtarake mbeti një mundësi e diskutuar, megjithatë, shumë diplomatë, përfshirë Sir E. Grey dhe Cambon, u shprehën të kujdesshëm, duke theksuar se një veprim i tillë mund të çonte në një përshkallëzim të mëtejshëm të tensioneve dhe në një rrezik për paqen evropiane.¹⁴⁷

Për shkak të presionit ndërkombëtar dhe mundësisë së një sulmi ushtarak nga Austro-Hungaria, Mali i Zi nuk kishte më mundësi për manovra. Më 4 maj, Mali i Zi u dorëzua dhe ia la fatin e qytetit të Shkodrës në duar të fuqive të mëdha.¹⁴⁸ Flota filloi përgatitjet për zbarkimin e trupave. Trupat serbe u larguan nga zona e betejës. Anija e fundit u largua më 3 maj nga Durrësi. Ky vendim i mbretit Nikolla për tërheqje ishte marrë, në radhë të

¹⁴³ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinete 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13227 Der Botschafter in London Fürst von Lichnowsky an das Auswärtige Amt Telegramm. Nr. 193 Entzifferung London, den 28. April 1913.

¹⁴⁴ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinete 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13227 Der Botschafter in London Fürst von Lichnowsky an das Auswärtige Amt Telegramm. Nr. 193 Entzifferung London, den 28. April 1913.

¹⁴⁵ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinete 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13232 Der Botschafter in London Fürst von Lichnowsky an das Auswärtige Amt Telegramm. Entzifferung London, den 28. April 1913.

¹⁴⁶ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinete 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13232 Der Botschafter in London Fürst von Lichnowsky an das Auswärtige Amt Telegramm. Entzifferung London, den 28. April 1913.

¹⁴⁷ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinete 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13252 Der Botschafter in London Fürst von Lichnowsky an das Auswärtige Amt Telegramm. Nr. 201 Entzifferung London, den 1. Mai 1913

¹⁴⁸ ÖUA 6, 6873 Giesesl drejtuar Berchtold 3.5.1913; Die Grosse Politik der Europäischen Kabinete 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13274 Der Botschafter in London Fürst von Lichnowsky an das Auswärtige Amt Telegramm. Nr. 206 den Entzifferung London, den 5. Mai 1913

parë, për shkak të qëndrimit të vendosur të Austro-Hungarisë.¹⁴⁹ Tërheqja malazeze ndikoi që edhe trupat serbe të tërhiqeshin nga veri i Shqipërisë, duke shënuar një tjetër zhvillim të rëndësishëm në këtë fazë të luftës. Në fund të telegramit, ambasadori gjerman në Londër theksonte në mbledhjen e radhës të ambasadorëve që do të mbahej të enjten, do të prezantohej statuti i Shqipërisë i dakordësuar ndërmjet Austro-Hungarisë dhe Italisë.¹⁵⁰

Në mbledhjen e 5 majit në Londër, u ndje një përshtypje e zgjidhjes së kënaqshme të çështjes së Shkodrës. U vendos që udhëheqësi i flotës ndërkombëtare të negociojë me malazezët për ditën kur një komision, i përbërë nga oficerë të flotës, do ta merrte qytetin në emër të fuqive të mëdha. Komisioni do të rregullonte procesin e evakuimit dhe largimit të ushtarëve dhe armëve.¹⁵¹

Për më tepër, Konferenca e Ambasadorëve vendosi që një komision i përbërë nga oficerë të caktuar nga komandantët dhe i shoqëruar nga detashmente ndërkombëtare, të organizonte marrjen e qytetit në emër të Fuqive të Mëdha, duke vendosur datën e evakuimit dhe të largimit të pajisjeve ushtarake. Pas evakuimit, do të hiqej bllokada dhe Fuqitë e Mëdha do të mbareshin në kontroll të qytetit derisa të organizohej një qeveri autonome të mund të merrte përsipër administratën. Më 8 maj, dërguari gjerman nga Cetinja von Eckardt, raportoi se ishte arritur një marrëveshje e plotë dhe e kënaqshme mes admirali britanik dhe negociatorëve malazezë për pastrimin e Shkodrës.¹⁵² Konferenca miratoi, gjithashtu instruksione për të hequr çdo pengesë për largimin e trupave osmane nga Shqipëria.¹⁵³

Pas këtyre zhvillimeve, Gjermania angazhohej që Austro-Hungaria dhe Italia të bashkëpunonin në çështjen e Shqipërisë, pasi kjo do të kishte një ndikim shumë të mirë për bashkëpunimin dhe do të jepte një mesazh të fortë të unitetit ndërmjet aleatëve të Aleancës Trepalëshe.¹⁵⁴

Përkrahja gjermane për politikën austro-hungareze në Shqipëri, përkatësisht në çështjen e Adriatikut dhe të Shkodrës, sfidoi veçanërisht

¹⁴⁹ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, Nr. 13272 Der Botschajter in Ëien von Tschirschky an das Auswärtige Amt Telegramm. Giesl meldet, Entzifferung Ëien, den 5. Mai 1913.

¹⁵⁰ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13276 Bericht des Militärattaches in Ëien Majors Grafen von Kageneck Abschrift Wien, den 4. Mai 1913

¹⁵¹ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13274 Nr. 13274, Der Botschafter in London Fürst von Lichnowsky an das Auswärtige Amt Telegramm. London, den 5. Mai 1913.

¹⁵² Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. Der Gesandte in Cetinje von Eckardt an das Auswärtige Amt Telegramm. Entzifferung Lichnowsky 13286 Cetinje, den 8. Mai 1913.

¹⁵³ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13274 Der Botschafter in London Fürst von Lichnowsky an das Auswärtige Amt Telegramm. Nr. 206 den Entzifferung London, den 5. Mai 1913

¹⁵⁴ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13271 Der Staatssekretär des Auswärtigen Amtes von Jagow an Botschafter in Wen von Tschirschky Telegramm. Nr. 207 Eigenhändiges Konzept Berlin, den 5. Mai 1913

Rusinë, fuqinë mbrojtëse të shteteve sllave të Ballkanit. Sazanov nuk donte të pranonte suksesin e Austro-Hungarisë e cila e vetme e detyroi mbretin Nikolla të largohej nga Shkodra. Zgjidhjen e krizësës Shkodrës në favor të pozicionit të Vjenës nëpërmjet një ultimatumit të qartë, Rusia e konsideronte edhe si humbje e prestigjit të saj ndërkombëtar. Më 5 maj 1913, në raportin e ambasadorit gjerman në Shën Petersburg, Graf von Pourtales, pasqyrohet qëndrimin e Rusisë ndaj çështjes shqiptare në vitin 1913, veçanërisht përballë planeve të Austro-Hungarisë dhe Italisë për ta vendosur Shqipërinë nën ndikimin e tyre. Rusia kundërshtonte një ndërhyrje të pavarur austro-italiane në Shqipëri dhe kërkon që çështja të rregullohet nga Fuqitë e Mëdha. Sazanov paralajmëron se Austro-Hungaria dhe Italia mund të qëndrojnë përgjithmonë në Shqipëri dhe insiston që çdo ndërhyrje të ketë një mandat evropian me përfshirjen e një pale të tretë.¹⁵⁵ “Rusia kishte pranuar krijimin e një Shqipërie autonome, por vetëm nëse çështjet e saj do të rregulloheshin nga Fuqitë e Mëdha. Rusia nuk mund të lejonte që Serbia dhe Greqia të përjashtoheshin nga Shqipëria, duke çuar në kontrollin e Austrisë dhe Italisë. Sazanov paralajmëroi se edhe një okupim i përkohshëm nga këto shtete mund të çonte në një prani të përhershme.”¹⁵⁶ Në fakt, ne dolëm përsëri me sukses nga një nga ato prova force që karakterizojnë politikën tonë. Rusia ishte e detyruar të tërhiqej nga ne në të gjitha pikat, pasi nuk ishte kurrë në gjendje të siguronte sukses për qëllimet serbe. Shqipëria u shpall një shtet vasal i Austrisë dhe Serbia u shty nga deti. Pra, kjo konferencë rezultoi në një poshtërim të ri për krenarinë ruse. Ashtu si në vitin 1878 dhe në 1908, ne kundërshtuam planet ruse, edhe pse nuk ishin të përfshira interesa gjermane.¹⁵⁷

Pasi mori këtë telegram, Ministria e Jashtme e Gjermanisë i dha urdhër komandantit të anijes “Breslau”, e cila ishte e vendosur pranë Shkodrës, për t’u përgatitur për çdo veprim të nevojshëm.¹⁵⁸ Duhet pranuar se strategjia e dyfishtë e kancelarit perandorak gjerman, Bethmann Hollweg, e mbështetjes së Austro-Hungarisë dhe e bashkëpunimit të ngushtë me Anglinë, pati sukses për dëbimin e Malit të Zi nga Shkodra dhe serbëve nga Durrësi, paanësisht nga veriu i Shqipërisë. Natyrisht një meritë për këtë i takon edhe ambasadorit Lichnowsky, i cili kishte raporte të ngushta me sekretarin Edward Grey. “Pasi mbërrita në Berlin, pashë kancelarin dhe i thashë se e konsideroja gjendjen e marrëdhënieve tona ndërkombëtare shumë të kënaqshme, pasi ishim në

¹⁵⁵ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13276 Bericht des Militärattachés in Wien Majors Grafen von Kageneck Abschrift Wien, den 4. Mai 1913

¹⁵⁶ Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914 - GP 34, II, Nr. 13275 Der Botschafter in Petersburg Graf von Pourtales an das Auswärtige Amt Telegramm. 146 Herr ernste Entzifferung Petersburg, den 5. Mai 1913.

¹⁵⁷ Prince Lichnowsky, My Mission to London 1912-1914, f. 16.

¹⁵⁸ Nr. 13275 Der Botschafter in Petersburg Graf von Pourtales an das Auswärtige Amt Telegramm. 146 Herr ernste Entzifferung Petersburg, den 5. Mai 1913

marrëdhënie më të mira me Anglinë se sa kishim qenë për një kohë të gjatë,”¹⁵⁹ shkruan ambasadori gjerman në kujtimet e tij.

Bethmann Hollweg ia doli të mbante perandorin Wilhelmi II, I cili do të kishte hequr dorë me qejf nga projekti shqiptar. Perandori gjerman iu bind pikëpamjeve të kancelarit të tij dhe e lejoi politikën të vepronte. Bindja e tij sidomos në çështjen e pushtimit ushtarak të Shkodrës nga repartet e Marinës së Fuqive të Mëdha: megjithëse perandori e kishte refuzuar energjetikisht këtë gjë, ai duhet të pranonte se ushtarët e marinës gjermane zbarkuan në Shqipëri dhe e pushtuan qytetin bashkë me to.¹⁶⁰ Në këtë mënyrë, Gjermania doli në mbështetje që të realizohet Demarshi në Cetinje për shkak të kalimit të Shkodrës tek Fuqitë e Mëdha, për të përshpejtuar ose siguruar realizimin e vendimit evropian në mënyra të tjera.

Ndërkaq, lidhur me pjesëmarrjen në huanë malazeze mund ta sigurojmë natyrisht vetëm nëse miratohet nga Reichstag-u, ishte qëndrimi i Ministrisë së Jashtme të Gjermanisë.

Ky triumf, natyrisht i pjesshëm për shqiptarët, megjithatë ishte një dështim i Rusisë, e cila e mbështetur nga Franca, në gjysmën e parë të Luftës Ballkanike, synonte ta bënte fitoren e popujve ballkanikë mbi Perandorinë Osmane sa më të plotë, ndërsa në gjysmën e dytë, më të gjatë të luftës, qëllimi i dublimit ishte që të ruante Aleancën Ballkanike dhe ta mbante atë si një anëtar të mundshëm të Traktatit Trepalësh. Për këtë arsye, u pengua që aleatët të bënin marrëveshje të veçanta me Perandorinë Osmane.

Përpjekjet ruse, po ashtu, penguan marrëveshjen direkte midis Bullgarisë dhe Turqisë. Të gjithë aleatët duhej të ishin të kënaqur njësoj për të shmangur ndonjë konflikt mbi përfitimet territoriale. Adrianopoli (Edreneja) duhej të ishte bullgar, Manastiri do t'i mbetej Serbisë, Selaniku Greqisë, dhe Siliestia do t'i kalonte Rumanisë. Por nga kriza për Shkodrën, Rusia nxorri një përfitim të madh në favor të popullit serb prej heqjes dorë të Malit të Zi nga Shkodra, ishte fakti që Austro-Hungaria u pajtua t'ia linte Serbisë qytetet e Kosovës. të Pejës, Gjakovës Prizrenit dhe Dibrës.¹⁶¹ Pavarësisht Sazanovit në këtë proces, diplomacia ruse pati mbështetjen e qeverisë së Berlinit,¹⁶² një gjë e tillë nuk faktohet me dokumente diplomatike të kohës.

Por në një lojë të vazhdueshme intrigash kundër Konferencës së Ambasadorëve në Londër, Rusia dhe Franca arritën të afroreshin gjithnjë e më shumë me qëllimin e tyre. A do ta arrijnë plotësisht këtë qëllim është e paqartë, por është e sigurt se lufta Ballkanike u zgjat për shkak të pengesave dhe vonesave të shkaktuara nga Rusia dhe Franca. Është fakt, po ashtu, se në

¹⁵⁹ Prince Lichnowsky, *My Mission to London 1912-1914*, f. 32.

¹⁶⁰ Nr. 13179 Der Staatssekretär des Auswärtigen Amtes von Jagow an den Nr. 6 Der Rat im Kaiserlichen Gefolge Gesandten von Treutler, 2. Z. in Homburg v. d. H. Ausfertigung Berlin, den 20. April 1913.

¹⁶¹ Sazanov, Sergej Dmitrievič, *Kujtime*, f. 120.

¹⁶² Sazanov, Sergej Dmitrievič, *Kujtime*, f. 120.

çështjen e kufijve të Shqipërisë, Rusia e mbështeti zgjerimin territorial të Serbisë, si në vitet 1877-1878. Austro-Hungaria dëshironte që shtetit shqiptar t'i bashkoheshin edhe territoret tjera me shumicë shqiptare në perëndim të Kosovës (me Prizrenin, Pejën, dhe Gjakovën), si dhe Dibra dhe Ohri. Megjithatë në negociatat e gjata në Konferencën e Londrës midis përfaqësuesve të Austro-Hungarisë dhe Rusisë, kufiri shqiptar u zhvendos gjithnjë e më shumë drejt perëndimit. Në fund gjysma shqiptare e territoreve mbetën jashtë shtetit të sapo shpallur shqiptar, një nga trashëgimitë më të rënda të historisë ballkanike të shekullit XX.

Në fakt, përfundimi i krizës së Shkodrës shënoi edhe vendosjen e kufijve të parë të Shqipërisë në veri. Problemet e shtetit të ri të Shqipërisë vazhduan, veçanërisht në lidhje me çështjen e fronit. Po ashtu, kufijtë e ardhshëm të shtetit dhe stacionimi i trupave ndërkombëtare u ndërlidhën me këto çështje, duke u zgjatur deri në vitin 1914. Përcaktimi i detajuar i linjave kufitare drejt Serbisë dhe Malit të Zi u vendos vetëm në vitin 1914 nga një Komision i posaçëm i gjashtë fuqive evropiane.¹⁶³ Në kufirin e vendosur nën ndikimin e drejtpërdrejtë dhe në prapaskenë të aleates së saj Francës, lindi çështja e Kosovës.¹⁶⁴

Konkluzion

Edhe sot krijimi i Shqipërisë së pavarur i atribuohet Austro-Hungarisë, e cila ishte rivalja kryesore e Rusisë dhe përpiquej që përmes Aleancës Ballkanike të vendoste hegjemoninë e saj mbi Ballkan. Duke marrë parasysh interesat e Austro-Hungarisë në Ballkan dhe mundësisë së shpërthimit të një lufte evropiane, Gjermania ashtu si në vitet 1980 në luftën e Kosovës që mori nismën për Konferencën e Rambujesë, u propozoi Fuqive të Mëdha të Koncertit Evropian një konferencë ambasadorësh për rregullimin e çështjeve ballkanike. Problemi qendror ishte prishja e status quo-së e cila rrezikonte interesat e Austro-Hungarisë së Ballkan, të cilat sfidoheshin nga Rusia e cila përmes Aleancës Ballkanike synonte të forconte pozicionin e saj në rajon. Kundër ambicieve pansllaviste ishte pozicionuar Austro-Hungaria, e cila pa ndihmën e aleatit të saj, Gjermanisë nuk mund të frenonte ambiciet e Serbisë. Berlini ishte i vetëdijshëm se një disfatë e aleatit të saj në Aleancën Trepalëshe, Austro-Hungarisë, do të rrezikonte pozitën e Aleancës Trepalëshe dhe si rrjedhojë e drejtpërdrejt do të dobësonte pozitën e Perandorisë Gjermane. Por, nga ana tjetër, Berlini nuk dëshironte të rrezikonte marrëdhëniet me Anglinë për shkak të një veprimi arbitrar të Berchtoldit, i cili mund të çonte

¹⁶³ Adalbert Gotfried, Krause, Das Problem der albanischen Unabhängigkeit in den Jahren 1908-1914, Phil. Diss, Wien 1970, f. 204; Conrad, Aus meiner Dienstzeit, Bd.I, f. 122. f. 243.

¹⁶⁴ Schmit, Oliver Jens, Der Balkan im 20. Jahrhundert-Eine postimperiale Geschichte, Verlag E. Kohlhammer Verlag, 2019, f. 32.

në luftë. Gjermania donte ta ruante Austro-Hungarinë si një Fuqi të Madhe, por njëkohësisht duhej ta paralajmëronte kundër veprimeve arbitrare, duke mos lejuar që shpata gjermane të tundej në çdo situatë. Pra, roli i Gjermanisë, me gjithë luhajtjet dhe synimet për një afrim me Anglinë, ishte vendimtare që Austro-Hungaria të ndiqet kursin e saj për krijimin e një shteti shqiptar në Ballkan. Natyrisht, përkrahja e Gjermanisë për politikën e Vjenës sfidoi veçanërisht Rusinë, si dhe pozicionin e Francës. Për diplomacinë Gjermane krijimi i Shqipërisë do të ishte një sukses i domosdoshëm për ruajtjen e prestigjit të Austro-Hungarisë si fqinj evropian, prandaj ekzistonte mendimi se përkrahja e Vjenës ishte edhe në interesin e Gjermanisë dhe të ruajtjes së Aleancës Trepalëshe si kundërpeshë e Antantës. Zgjidhja e çështjes shqiptare, po ashtu, ruante edhe autoritetin e Koncertit Evropian. Në këtë kuadër diplomacia gjermane edhe zgjidhjen e çështjes së Shkodrës të pushtuar nga Mali i Zi e shihte përmes një politike “energjiqe” jo vetëm të Vjenës, por edhe të shteteve të Antantës. Në fakt, lidhur me Shkodrën, Berlini favorizonte një bashkëveprim dhe bashkëpunim me Anglinë.

Edhe pse Berlini nuk e “pengonte” një aksion të pavarur të Austro-Hungarisë, megjithatë angazhohej për një veprim kolektiv të Koncertit Evropian. Rreshtimi i Gjermanisë përkrah Austro-Hungarisë, e shtyri edhe Rusinë të bëhej më e përmbytur në çështjen e realizimit të ambicieve të larta të Serbisë, siç ishte rasti i pretendimit të Beogradit për një port serb në Adriatik. Ndërkaq, dallimet e brendshme, luhajtjet e perandorit gjerman Wilhelmi II rreth projektit shqiptar, u tejkaluan falë vendosmërisë së kancelarit gjerman Bethann Hollweg, i cili ia doli të impononte linjën e tij politike, për demonstrimin e flotave përpara bregdetit malazez për çështjen e Shkodrës. Në të njëjtën kohë, kancelari gjerman nuk ishte i gatshëm të ndiqte verbërisht politikën e Vjenës dhe të rrezikonte afrimin gjermano-anglez. Ai gjithashtu nuk dëshironte të thellonte konfliktin e Rusinë dhe për këtë e nxiti ministrin e jashtëm austro-hungarez të lëshonte pe në çështjen e kufirit. Pra, Berlini që i gatshëm vetëm në shkallë të kufizuar të përkrahte kërkesat e Bertholdit.

Ambasadori gjerman, princi Lichnowsky, në prag të Konferencës së Londrës, ishte udhëhequr nga Berlini që gjatë diskutimeve të sillej në harmoni me kolegët e Aleancës Trepalëshe. Në këtë kontekst, ai duhej të përkrahte ambasadorin austro-hungarez për krijimin e Shqipërisë si një shtet i aftë për të jetuar dhe duhej të ruante kufijtë, të cilët do të ishin sipas të dhënave “natyrore” dhe gjeografike.

Meqë Gjermani shquhej për lidhjet e ngushta ekonomike, ajo nuk kishte ndonjë plan apo projekt konkret për çështjen e kufijve të Shqipërisë. Sipas të Ngarkuarit me Punë të Gjermanisë në Londër, Kühlmann qysh para Konferencës së Londrës, problemi i vetëm i ndërlikuar, sipas informacionit të marrë nga Austria, konsiderohej përcaktimi i kufijve të Shqipërisë autonome. Diplomati gjerman kishte përshtypjen se Austria dëshironte një Shqipëri shumë të madhe, e cila në veri do të kufizohej drejtpërdrejt me Malin e Zi,

ndërsa serbët e siguronin atë, pa ia kërkuar ai, se duhej patjetër të kishin një dalje në Adriatik. Kjo ishte një çështje jetike për Serbinë dhe, pa të, të gjitha arritjet e tjera do të ishin të pavlera. Atij i dukej se një kompromis mund të gjendej përmes një linje hekurudhore drejt Adriatikut. Diplomacia gjermane ishte e vetëdijshme se serbët e gëzonin mbështetjen ruse si në çështjen e pushtimit të Shqipërisë ashtu edhe në çështjen e daljes në Adriatik dhe problemet tjera për përcaktimin e kufirit. Siç e konfirmojnë edhe aktet diplomatike të kohës, Berlioni kishte bërë përpjekje për gjetjen e një marrëveshjeje përmes komunikimeve me Parisin dhe Londrën, por njëkohësisht e kishte bërë të qartë pozicionin se Austro-Hungaria ishte e vendosur t'i mohonte Serbisë daljen në Adriatik dhe se Gjermania ishte e vendosur ta mbështeste Austrinë në këtë çështje.

Roli i Gjermanisë në Konferencën e Ambasadorëve u realizua përmes punës ndërmjetësuese së bashku me Anglinë, të cilën dëshironte ta ndante nga Antanta. Krahës bashkëpunimit Anglo-Gjerman për të ardhmen e Ballkanit, Berlinit ishte i interesuar prej kohësh për thellimin e bashkëpunimit gjermano-anglez. Pra, Gjermania dëshironte të evitonte një konfrontim me Anglinë, e cila që nga dhjetori i vitit 1912 e kishte bërë të qartë përmes ambasadorit Lichnowsky se Londra nuk do të qëndronte asnjëherë në një luftë të përgjithshme në Evropë, por do të ishte e gatshme të ndihmonte Francën kundër një sulmi gjerman. Ky ishte një sinjal që e bëri Gjermaninë të ishte e kujdesshme dhe të mos ndërmerre ndonjë aventurë diplomatike që do të mund të kishte pasoja në raport me fuqitë e Antantës. Duke pasur parasysh konfrontimin e mundshëm ruso-austriak, perandori gjerman Wilhelmi i II hoqi dorë nga qëndrimi fillestar asnjëherë kundrejt fateve të Austro-Hungarisë në Ballkan.

Siç e ka pohuar edhe vetë Edward Grey, qëndrimi i Gjermanisë ishte shumë i rëndësishëm. Që në fillim, ajo synonte suksesin e Konferencës, përndryshe nuk do të kishte marrë pjesë. Edhe pse nuk ushtroi presion ndaj Austrisë dhe shpesh lejonte zvarritjen e çështjeve, Gjermania ishte e vendosur të shmangte luftën. Për këtë qëllim, ajo kishte një përfaqësues të përkushtuar në Lichnowsky, i cili e urrente idenë e luftës. Meqë Rusia pranoi parimin e një Shqipërie të pavarur, Lichnowsky e konsideronte të panevojshme që mosmarrëveshjet e vogla të çonin në luftë evropiane. Ndërsa detyra e tij zyrtare ishte të mbështeste Austrinë, ai shpesh shprehte përbuzje për debatin e gjatë mbi ndarjen e disa fshatrave në kufirin shqiptar.”¹⁶⁵

Me këtë qasje ekuilibruese Berlioni provonte të shmangte një konfrontim ushtarak ndërmjet Aleancës Trepalëshe dhe Antantës, përfshirë Anglinë. Strategjia e dyfishtë e kancelarit gjerman, e mbështetjes së Austro-Hungarisë dhe e bashkëpunimit me Anglinë, si rrjedhojë, ishte e suksesshme. Në të njëjtën kohë, Gjermania gjatë gjithë punimeve të Konferencës së Ambasadorëve bëri përpjekje për të luajtur rol ndërmjetësues mes Aleancës Trepalëshe, pasi Italia dhe Austria kishin interesa të drejtpërdrejta në Ballkan dhe ishin në

¹⁶⁵ Grey, Viscount Of Fallodon, *Twenty Five Years 1892-1916*, New York 1925, f. 675-676.

rivalitet me njëra-tjetrën. Ajo shpesh u përdor nga fuqitë e tjera për të ndikuar në qëndrimin e Austro-Hungarisë, kur ky shtet perandorak tregohej i pathyeshëm në disa çështje, posaçërisht në çështjet e Adriatikut dhe të Shkodrës. Në përgjithësi mund të thuhet se Gjermania luajti një rol pozitiv në çështjen e krijimit të Shqipërisë, përcaktimit të kufijve të shtetit shqiptar, në zgjidhjen e krizës së Shkodrës, si dhe në çështjen e Adriatikut. Si rrjedhojë e këtij qëndrimi të përbashkët, para së gjithash, mbështetjes së vazhdueshme të Gjermanisë për pozicionin e Austro-Hungarisë, në Konferencën e Ambasadorëve në Londër lindi Shqipëria, e cila ishte simfonia e lamtumirës së Koncertit Evropian.